

1 E martë, 12 prill 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi.

7 Z. Sekretar, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar.

9 Kjo është lënda KSC-BC-2020-05, Prokuroria i Specializuar
10 kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Mirë. Ju lutem të paraqitemi.

14 Z. Prokuror, fjala është për ju.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar.

16 Mirëmëngjes, të gjithëve. Prokuroria përfaqësohet sot nga

17 Silvia D'Ascoli, Ndhmësprokurore; Line Pedersen,

18 Administratore e Çështjes; dhe, Marie-Cecile Grudzinski, është

19 stazhiere; dhe unë, Cezary Michalczuk, Prokuror.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Mbrojtësja e Viktimave, fjala është për ju.

22 ZNJ. VOSENBERG:[Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar.

23 Mirëmëngjes, të gjithëve. Mbrojtësja e Viktimave përfaqësohet

24 sot nga unë, Brechtje Vossenber, Bashkmbrojtëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Avokati Mbrojtës fjala është për ju.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar. Mbrojtja
3 përfaqësohet nga z. Betim Shala, Ndihmësmbrojtës; unë, Julius
4 Von Bone; dhe hetues dhe përkthyes z. Fatmir Pelaj. Sot në
5 sallën e gjyqit kemi edhe z. Mustafa.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Për procesverbal, jemi sot përpara Trupit Gjykses numër
9 I.

10 Mirë atëherë, të shohim pak programin e ditës së sotme.
11 Pikë së pari do të fillojmë me disa nga pikat që dua t'ju
12 përmend. Do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes
13 1000, z. Nuredin Ibishi.

14 Sikurse u komunikua dhe me email, Trupi Gjykses sot do të
15 ketë një seancë shtesë. Ua dërguam këtë më 8 prill 2022 në
16 orën 13.11. Nëse është e nevojshme sot do të qëndrojmë deri në
17 orën 5.30 të pasdites.

18 Para se të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 1000, Trupi
19 Gjykses dëshiron të dijë prej Mbrojtjes nëse mund t'i japë
20 përgjigje pyetjes së djeshme nga Trupi Gjykses sa i takon
21 disponueshmërisë të akuzuarit për të bërë një deklaratë jo nën
22 betim në datat 17, 18 dhe/ose 19 maj 2022, kohëzgjatja e
23 parashikuar e deklaratës dhe nëse i akuzuari do t'i përgjigjet
24 pyetjeve të ngritura nga Trupi Gjykses para apo pas
25 deklaratës.

1 Avokati Mbrojtës, fjala është për ju.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë më 19 maj
3 do të ishte data më e përshtatshme. Sa i takon kohëzgjatjes
4 edhe pyetjes për ngritjen e pyetjeve, më jepni pak kohë ju
5 lutem, t'u përgjigjem pas pushimit të drekës, nëse është
6 dakord me ju. Të konsultohemi në ekip.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
8 mirë, Avokat Mbrojtës. Sa i takon kohëzgjatjes -- e kuptoj që
9 duhet të diskutoni. Po do të donim që ta bënim atë javë. Nëse
10 ju duhet më shumë kohë, atëherë unë do ju sugjeroja datën 18,
11 19. Ka më shumë -- është më e përshtatshme për të gjithë.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Besoj se do jetë vetëm një ditë
13 në fakt. Gati e sigurtë do jetë vetëm një ditë. Megjithatë do
14 ju them sot pasdite për kohëzgjatjen.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
16 mirë, z. Avokat Mbrojtës.

17 Mirë, atëherë. Mund të vazhdojmë me Dëshmitarin e
18 Mbrojtjes numër 1000.

19 Znj. Asistente e Gjykatës silleni dëshmitarin në sallën e
20 gjyqit.

21 [Dëshmitari hynë në sallën e gjyqit]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Ibishi, mirëmëngjesi dhe mirë se erdhët në Dhomat e
24 Specializuara. A më dëgjoni?

25 DËSHMITARI: Po. Mirëmëngjesi, znj. Kryetare me stafin e

1 juj, prokurorë, avokate, avokatë, z. Salih. Përshëndetje.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
3 jeni?

4 DËSHMITARI: Mirë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Ibishi, sot do të fillojmë dëshminë tuaj. Jeni thirrur të
7 dëshmoni para Dhomave të Specializuara në çështjen Prokuroria
8 e Specializuar kundër Salih Mustafës për të ndihmuar Trupin
9 Gjykues të arrijë në vendimin e duhur.

10 Pasi të bëni betimin tuaj për të dhënë të vërtetën, do ju
11 bëjnë pyetje Avokatët Mbrojtës, përfaqësuesit e Prokurorisë si
12 dhe avokatët -- edhe Mbrojtësit e Viktimave.

13 Do të doja t'ju jepja disa këshilla sa u takon
14 përgjigjeve lidhur me pyetjet që ju do ju bëjmë. Më dëgjoni me
15 kujdes, ju lutem. Dëgjoni me kujdes të gjitha pyetjet. Nëse
16 s'i kuptoni, lirisht kërkoni të përsëritet pyetja.

17 Duam të thoni të vërtetën dhe të na thoni çfarë keni
18 parë, çfarë keni dëgjuar, çfarë keni përjetuar, çfarë keni
19 ndjerë. Nëse i keni zbuluar gjërat në formë tjetër, ju lutem
20 na thoni si i keni marrë vesh. Na i shpjegoni si i keni marrë
21 vesh gjëra të caktuara.

22 Mbase s'i mbani mend të gjitha hollësitë e ngjarjeve.
23 Është krejt normale. Ju lutem dëshmoni mbi ato çka mbani mend.
24 Është krejt normale për ne të na thoni dhe "S'e di", "S'e mbaj
25 mend".

1 Ju lutem përgjigjuni pyetjes. Nëse ka nevojë për sqarime
2 të mëtejshme, do ju kërkojmë ne të jepni sqarime të mëtejshme.
3 Mund t'ju ndërpres nëse devijon nga përgjigja e pyetjes që ju
4 keni bërë. Ju lutem qëndroni i përqendruar.

5 Gjithashtu dua t'ju kujtoj që mund të refuzoni t'i
6 përgjigjeni pyetjeve mbi aspekte që mund t'ju inkriminojnë ju
7 vetë.

8 E kuptoni?

9 DËSHMITARI: Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
11 doja po ashtu t'ju jepja disa këshilla praktike për dëshminë.

12 Çdo gjë që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet. Është
13 e rëndësishme të flasim te mikrofoni, pra, te mikrofoni që
14 keni përpara, pikërisht. Të flisni ngadalë ju lutem dhe të
15 flisni qartë.

16 Ju lutem filloni të përgjigjeni vetëm pasi personi që ju
17 ka bërë pyetjen e ka mbaruar pyetjen. Kur ju bëjnë një pyetje,
18 ju lutem numëroni në kokë deri në pesë dhe vetëm pastaj
19 përgjigju. Dhe këmbëngul te kjo pesë, e theksoj këtë pjesë,
20 është tejet e rëndësishme sepse ky pesë sekondëshi është shumë
21 i rëndësishëm që ne të ndjekim tamam ato që po na thoni.

22 Pra, kur Avokati Mbrojtës t'ju ketë bërë një pyetje -
23 dhe me sa kam kuptuar unë, do të jetë në shqip, pyetjet do t'i
24 kemi në shqip z. Shala, po kështu është - ju lutem prisni pak.
25 Edhe pse instinkti është të përgjigjesh menjëherë, ju lutem

1 prisni pak ta ketë përfunduar pyetjen pesë sekonda dhe pastaj
2 përgjigjuni. Sepse përndryshe përkthimi i z. Shala dhe ajo që
3 thoni ju mbivendosen me njëra-tjetrën dhe atëherë ne nuk e
4 kuptojmë dot se çfarë po thuhet këtu.

5 Është e qartë?

6 DËSHMITARI: E qartë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Nëse ngre dorën, ju lutem pushoni së foluri. Arsyeja pse
10 ngre dorën është se nuk dua të ndërpres fjalinë se pastaj kemi
11 mbivendosje të fjalive dhe nuk duam që të ndodhë.

12 Ndonjëherë do ju kërkoj të hiqni dëgjueset e t'i vendosni
13 në tavolinën përpara jush ose mund t'i kërkojë Asistentes së
14 Gjykatës t'ju nxjerrë nga salla e gjyqit në rast se duhet të
15 diskutojmë diçka lidhur me përmbajtjen e pyetjeve që do ju
16 bëjnë.

17 Nëse ju keni ndonjë pyetje, nëse keni nevojë për pushim,
18 nëse keni nevojë për çfarëdolloj ndihme ju lutem ngrini dorën
19 dhe ne do ju japim fjalën.

20 Është e qartë?

21 DËSHMITARI: E qartë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

23 Ibishi, flisni anglisht?

24 DËSHMITARI: Nga pak.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit. Atëherë, mund të ndodhë që të na duhet të
2 shoqërojmë jashtë sallës së gjyqit kur të diskutojmë
3 përmbajtjen e pyetjes.

4 Tani siç bëjmë me çdo dëshmitar, do ju kërkojmë të na
5 bëni betimin që do të thoni të vërtetën dhe ju kujtoj se është
6 vepër penale në juridiksionin e Dhomave të Specializuara të
7 japësh një dëshmi të rreme.

8 E qartë?

9 DËSHMITARI: E qartë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
11 mirë.

12 Znj. Asistente ndihmojeni dëshmitarin të lexojë
13 deklaratën që do të thotë të vërtetën.

14 Ju lutem lexoni tekstin, z. Ibishi, që keni përpara.

15 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
16 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
17 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
18 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

19 DËSHMITARI: NUREDIN IBISHI

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit, z. Ibishi. Tashmë jeni nën betim për të thënë të
22 vërtetën.

23 Tani mund të fillojmë me dëshminë e Z. Ibishi, duke
24 filluar me pyetjet nga Avokatët Mbrojtës. Trupi Gjykes ka
25 autorizuar Mbrojtjen që t'i bëjë pyetjet në shqip Dëshmitarit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Shala

Faqe 8

1 1000 dhe ky autorizim është bërë me emailin e datës 8 prill
2 2022 në orën 15.56.

3 Keni parashikuar dy orë, z. Avokat Mbrojtës. Ju lutem
4 informoni Trupin Gjykses nëse ka ndonjë ndryshim, për qëllime
5 planifikimi.

6 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit.

7 Pyetje nga Z. Shala:

8 Py. Mirëdita, z. Dëshmitar.

9 Pë. Mirëdita.

10 Py. Z. Dëshmitar, unë sot do të doja të bisedoja me ju për
11 periudhën kohore prej vitit 1998 gjer në qershor të vitit
12 1999. Gjatë kësaj periudhe kohore si ishte situata në Kosovë,
13 situata e sigurisë në Kosovë?

14 Pë. Po situata e sigurisë në Kosovë ishte nën një okupim të
15 egër të regjimit serb. Dhe pas masakrave të vitit 2007, pra,
16 në Prekaz, Qerez dhe Likoshan, atëherë fillojë një organizim i
17 përgjithshëm i qytetarëve, përveç strukturave të Ushtrisë
18 Çlirimtare të Kosovës që ishin veç në gatishmëri, them
19 përgatitje. Por e gjithë popullata përfundimisht kuptoi se
20 vetëm me luftë mundet edhe të çlirohet Kosova.

21 Kështu që tash kur flasim për vitet që pasojnë, pra, për
22 vitin 2008, ishte ky viti i, domethënë, përgatitjeve edhe vetë
23 zhvillimit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gati në
24 të gjithë territorin e Kosovës. Flas për vitet 1998, 1999 pra,
25 mirëpo përgjithësisht po flas. Ndërsa, në veçanti, për zonën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Shala

Faqe 9

1 operative të Llapit pasi që kompetenca -- nëse muj me spjegue?
2 Py. Do vijmë aty. Faleminderit, z. Dëshmitar. Ju gjatë këtyre
3 dy viteve 1998, 1999 me çfarë aktiviteti jeni marrë?
4 Pë. Po deri në fillimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të
5 Kosovës, në zonën operative të Llapit, them, unë isha në
6 kontakt me atë lëvizjen për formimin e Ushtrisë Çlirimtare të
7 Kosovës, me heroin e kombit z. Hyzri Talla, me Saimir
8 Konoshevcin e disa tjerë, që i zhvillojshin aktivitetet, them,
9 kështu në terren, që ishin, them, ende në fazën përgatitore
10 dhe unë isha në Prishtinë. Po flas për Zonën Operative të
11 Llapit, ndoshta për aspekte të shpjegimit sa përfshinë ajo.
12 Zona Operative e Llapit, apo nënzona fillimisht, ka përfshi
13 kryeqytetin Prishtinën, Podujevën, Fushë-Kosovën dhe Obiliqin,
14 pra, është zona, pra, me një të katërtën e popullatës gati dhe
15 po aq edhe sipërfaqen domethënë tokësore, gjithashtu ka 100
16 kilometra kufi me Serbinë edhe çështje tjetër që ka qenë si
17 qendër administrative e Kosovës dhe kryeqytet njëkohësisht dhe
18 ka pasë përfaqësi.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, z. Dëshmitar.

21 Ju lutem, a mund t'i thoni dëshmitarit të përgjigjet fiks
22 në atë që kërkoni të merrni, se po marrim shumë informacion
23 mbi gjërat që bënte. Nuk e duam të gjithë shpjegimin të
24 shtjelluar gjerë, që nuk është në fakt thelbi i pyetjes. Mirë
25 është thelbi i pyetjes.

1 Z. SHALA:

2 Py. Z. Dëshmitar, ju kisha lut që aq sa mundeni të
3 përgjigjeni në pyetjen që ju parashtroj dhe të fokusoheni
4 vetëm rreth përgjigjes në bazë të pyetjes që ju kam parashtrë.
5 Pë. Po.

6 Py. Në qoftë se ka nevojë për ndonjë sqarim shtesë, atëherë
7 do të parashtroj pyetje edhe për qatë sqarimin shtesë.

8 Ju, personalisht, kur jeni kyç në Ushtrinë Çlirimtare të
9 Kosovës?

10 Pë. Po deri në kyçjen në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pra,
11 kam qenë unë në një formë në kontakt, në aktivitet, për
12 përgatitjen, për daljen apo për formimin e --

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

14 Dëshmitar, pyetja është: Kur u kyçët në UÇK? Nuk ka nevojë për
15 shpjegime ç'ndodhi më përpara. Datën kur, kur ndodhi?

16 Pë. Po dikun në qershor, në fund të qershorit të vitit, pra,
17 1998. Më saktë në 28 qershor të vitit 1998.

18 Z. SHALA:

19 Py. Cillës njësi apo cillës brigadë ju bashkangjitët?

20 Pë. Po ky ishte fillimi i formimit të Ushtrisë Çlirimtare të
21 Kosovës në zonën operative apo nënzonën operative të Llapit.
22 Edhe ende ishin, them, faza fillestare, them, e ardhjes së
23 vullnetarëve të rinj në fshatin Zaberxhë. Edhe kështu që ende
24 nuk kishte, them, strukturim të njësive por ishte ma tepër një
25 qendër ku u mblidhshin. Ishte fshati Zaberxhë, domethënë,

1 Komuna e Mitrovicës. Edhe aty fillum aktivitetshin e parë të,
2 domethënë, të rekrutimit, të trajnimit edhe ngritjes së
3 kapacitetit. Por ende s'ka pasë, në këtë fillim, ende të them
4 strukturim të njësive ushtarake.

5 Py. Roli juaj në fshatin Zaberxhë, cilli ka qenë në atë kohë?

6 Pë. Po sikur të gjithë tjerët, kam qenë vullnetar i Ushtrisë
7 Çlirimtare të Kosovës, pra, luftëtarë të lirisë.

8 Py. A keni pasë ndonjë detyrë specifike?

9 Pë. Po, pasi që kisha një karrierë --

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

11 lutem, të dy prisni pak mes pyetjes dhe përgjigjes, sepse më

12 duhet të jem në gjendje ta vlerësoj pyetjen që ju drejtohet ju

13 fillimisht. Dhe nëse përgjigjesh para se ta marr unë

14 përkthimin e pyetjes, unë nuk jam në gjendje ta bëj këtë

15 vlerësim.

16 Ju doni të ndani informacion me Trupin Gjygues, kështu që

17 duhet ta bëjmë këtë sakrificë të vogël që ta bëjmë të

18 kuptueshme për gjithsecilin. Nuk flasim të njëjtën gjuhë,

19 duhet ata kuptoni këtë, ju lutem.

20 Ju lutem, Avokat Mbrojtës, vazhdoni

21 DËSHMITARI: Po edhe njëherë, më fal. Ma specifik.

22 Z. SHALA:

23 Py. A kishit ndonjë detyrë specifike ju në atë kohë?

24 Pë. Po, pasi që kisha edukim edhe policor edhe ushtarak edhe

25 normal kisha një karrierë atëherë, domosdoshmërisht, kuptohet

1 që isha një faktor apo një edukator për pjesëtarët apo
2 vullnetarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pra, detyra ime
3 ishte trajner të them i, domethënë, ushtarëve të rinj në këtë
4 nënzonë.

5 Py. Thatë që në kohën kur u kyçët në Ushtrinë Çlirimtare të
6 Kosovës në Zonën Operative të Llapit, ende nuk ishin krijuar
7 brigadat. Kur u kriju brigada e parë?

8 Pë. Po brigada e parë u krijua apo dy brigadat e para u
9 krijuan dikun ka mesi i gushtit të vitit 1998. Pra, atëherë
10 ishte dhe urdhri i Shtabit të Përgjithshëm që të kalohet në
11 organizimin apo strukturimin ushtarak të nënzoneve në brigada
12 mandej dhe në njësitë vartëse.

13 Py. Me krijimin e brigadave, a u caktuan edhe komandantët e
14 atyre brigadave?

15 Pë. Po. Erdhën përfaqësuesit e lartë të Shtabit të
16 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe bënë
17 emërimin, pra, të zëvendëskomandantit, po me vendim, Kadri
18 Kastratit, zëvendëskomandantit të nënzonës, në atë kohë;
19 mandej Brigadës 151, pra, unë, Nuredin Ibishi; edhe 152,
20 Shaban Shala, Idriz Shabani, Luta, komandant. Pra, ishin këto
21 dy brigadat e para që u formuan.

22 Py. Ju a u emëruat komandant i Brigadës 151? Selia e brigadës
23 në atë kohë ku ishte? Shtabi i brigadës?

24 Pë. Po kur thashë në qershor, atëherë ishim në fshatin
25 Zaberxhë. Ndërsa ne ndërkohë, u transferuam në fshatin

1 Bajgorë. Në një shkollë fillore, e cila ishte boshatisur edhe
2 aty ishte, pra, selia e kësaj brigade. Edhe ajo ishte prapë,
3 nuk ishte e formume, ishte në ngritje të kapaciteteve apo në
4 formim e sipër.

5 Py. Sipas vlerësimit tuaj, sa ka zgjatë formimi, krijimi i
6 kapaciteteve të nevojshme të Brigadës 151?

7 Pë. Po trajnimi themelor i ushtarëve zgjatke dikun, jo dikun,
8 po saktësisht tri javë. Për ai, domethënë, niveli themelor për
9 ushtar, pasi që duhet kuptuar se të rinjtë tonë, ka që ishte
10 dhe pjesa dërrmuese e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të
11 Kosovës, asnjëherë s'kishin pasë kontakt me armë mu për shkak
12 të regjimit serb që e kishte -- nuk i kishte dhënë atë të
13 drejtë që të kryejnë ushtri apo të kenë njohuri ushtarake të
14 them.

15 Kështu që detyra e neve instruktorëve ushtarakë edhe
16 policor ishte që t'i asojmë ata për njohuritë elementare; duke
17 filluar prej njohurive të përgjithshme, rregullat, disiplinën,
18 deri edhe rregullat ndërkombëtare të luftës, pra, katër
19 konventat e Gjenevës dhe dy protokollet shtesë, mandej
20 aspektet e të drejtave të njeriut në kuadër të forcave të
21 armatosura deri te lëvizja e ushtarëve në luftë, mandej
22 përdorimin e armës, mandej veprimin nën njësit, lëvizja në
23 natyrë e të gjitha çështje tjera --

24 Py. z. Dëshmitar --

25 Pë. -- që lidhen me ngritjen kapaciteteve të ushtarëve.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Mendoj se përgjigja tani, në fakt, ishte krejt konkrete, ishte
3 tamam për pyetjen tuaj. Por mendoj, ai dha shumë hollësi. Po
4 në qoftë se keni pyetje të tjera, pyetje tjetër të lidhur me
5 këtë, ju lutem vazhdoni.

6 Z. SHALA:

7 Py. Pas kryerjes së këtyre trajnimeve, shkollimeve të
8 ushtarëve vullnetarëve të rinisë kosovare që dëshironte t'i
9 bashkangjitej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - përsëri edhe
10 njëherë po e përsëris pyetjen - qa ai strukturimi, sa ka
11 zgjatë, si mbas mendimit tuaj, prej ditës kur është themelu?
12 Përafërsisht, sa ka dashë periudhë kohore të kalojë që ju ta
13 konsideroni që brigada e ka arrit atë nivelin organizativ të
14 kënaqshëm ta them?

15 Pë. Ajo është --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

17 Avokat Mbrojtës, mesa duket se kjo stërvitja -- përgjigja që
18 morëm për stërvitjen, nuk ishte ajo që nënkuptuam me pyetjen
19 tuaj. Apo e kam kuptuar siç duhet unë?

20 Z. SHALA: [Përkthim] Jo, se kërkova për -- se pyeta për
21 stërvitjen unë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
23 herën tjetër, se unë po vrisja mendjen pse po flisnim këtu për
24 stërvitjen, sepse është pyetja juaj dhe ju dukeni i kënaqur me
25 shpjegimin lidhur me stërvitjen. Unë, në fakt, mendova se këtë

1 po kërkoje të dëgjoje. Po nëse nuk ishte kjo përgjigja që
2 doje, atëherë mesa duket dëshmitari nuk ka kuptuar pyetjen,
3 kështu që ndërprite dëshmitarin dhe mund t'i pyesni vërtetë
4 atë që doni të dini. Unë nuk dua të pyes linjën tuaj të
5 pyetjeve, po unë s'e kuptova pse po flisnit këtu për
6 stërvitje. Kështu që herën tjetër do ju ndërpres unë më shpejt
7 në qoftë se nuk e bëni ju.

8 Z. SHALA:

9 Py. A ta përsëris pyetjen a mund të vazhdojmë?

10 Pë. Në qoftë se mundni ma specifike tash?

11 Py. Po. Prej momentit kur është kriju brigada, sa periudhë
12 kohore ka kalu deri në organizimin e duhur të brigadës,
13 strukturimin e nevojshëm të një brigade?

14 Pë. Po. Duhet kuptuar që ishim në kushte të jashtëzakonshme
15 fushore. Ishim në mal. Nuk kishim kapacitete as të vendosjes,
16 as nuk kishim aspektet logjistike, uniformat, pajimet edhe
17 normal edhe kushte të tjera. Kështu që për atë, koncepti ynë
18 ishte që të mund me ik zonave urbane, shkum që të krijojmë
19 ushtrinë në -- t'i ngrisim kapacitetet individuale -- mund të
20 vazhdoj?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
22 lutem, përpiquni më shkurt me -- pra, t'i përgjigjeni vërtetë
23 thelbit të pyetjes së Avokatit Mbrojtës. Nuk kemi nevojë për
24 shtjellime të gjera, për përgjigje të gjera. Përpiquni t'i
25 përgjigjeni thelbit të pyetjes. Nëse s'e kuptoni ju atëherë

1 kërkojani Avokatit ta sqarojë pyetjen. Po nuk duam që të
2 flasim për shumë gjëra, jam e bindur që mund të na thoni nga
3 përvoja juaj, nga pozicioni juaj, shumë gjëra, lidhur me ato
4 që kanë ndodhur në ato në ato vite në Kosovë, po duam një
5 përgjigje konkrete apo informacion konkret për Mbrojtjen që
6 mund të jetë i dobishëm për Trupin Gjykues në mënyrë që të
7 gjejmë të vërtetën.

8 Z. Avokat Mbrojtës, ju lutem bëni një pyetje konkrete,
9 specifike, sepse të flasësh për brigadat është shumë më e
10 gjerë. Ose riformuloje ose kalo tek pyetja tjetër, ju lutem.

11 Z. SHALA:

12 Py. Nga dita e themelimit të brigadës, përafërsisht sa ka
13 kalu kohë derisa janë kriju të gjitha strukturat që duhet ta
14 ketë një brigadë? Strukturat udhëheqëse.

15 Pë. Po është vështirë të përgjigjem kështu në mënyrë të
16 përgjithësuar. Se edhe Kryetarja e Trupit Gjykues më tërhoqi
17 vërejtjen, se nëse i përshkruan të gjitha këto hollësitë rreth
18 kushteve çfarë kanë qenë atëhere. Atëhere gati vështirë kemi
19 qenë me arrit atë, them, plotësimin edhe kuantitativ edhe
20 kualitativ të brigadës që ajo me qenë, dua të them, e gatshme
21 në aspektin luftarak. Kështu që kjo është pyetje -- përgjigja
22 është shumë relative. Ne asnjëherë s'kemi mujtë brigadën me
23 arrit as në aspektin kuantitativ, as kualitativ. Ne kemi --
24 jemi mundue duke i edukuar ushtarët në trajnimin bazik mandej
25 në kuadër të njësive prej grupit, skuadrës, të togut, të

1 kompanisë, batalionit deri në brigadë për me funksionalizu
2 sistemin. Mirëpo realisht ajo ka qenë ma tepër improvizim, nuk
3 kemi mujtë për një kohë të caktume ta bëjmë brigadën ashtu
4 funksionale. Ma tepër jemi mundue jo të improvizojmë, po të
5 arrijmë një, them, një kapacitet të mjaftueshëm që mundet ajo
6 me ju përgjigj një situatë, pra, të ballafaqimit me forcat
7 kundërshtare.

8 Kështu që është konform kushteve që kemi pasë ne, është e
9 pamundshme me e arrit atë perfor -- atë nivelin e standardit
10 çfarë e do ta ketë një brigadë, them, e një standardi të NATO-
11 s apo ndonjë shteti që ka një forcë të armatosur domethënë
12 respektabile.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
14 ishte një përgjigje. A je i kënaqur me këtë përgjigje?

15 Vazhdoni atëherë.

16 Z. SHALA:

17 Py. Kjo situatë ka qenë edhe me Brigadën 152?

18 Pë. Tash në kushtet -- më fal, është në rregull?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Vazhdoni

21 DËSHMITARI: Në kushtet reale, po flas pa pretendue se kem
22 formu brigada në kapacitete të plota, derisa brigada 152 ka
23 arrit një nivel, të them, të funksionalitetit dhe të
24 pozicionimit në terren, Brigada 151, brigada ku isha komandant
25 unë, ishte ende në fazën e ngritjes së kapaciteteve. Në --

1 flas për kohën që i referohem gushtit të vitit 1998.

2 Py. Po. Faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Avokati Mbrojtës, pyetja juaj ishte për Brigadën 152 apo jo?

5 Z. Dëshmitar, thjesht përgjigjuni për Brigadën 152, pasi
6 atë përmendi ai. E kemi -- vetëm përgjigjuni për 152.

7 Avokati Mbrojtës, ju e keni fjalën.

8 Z. SHALA:

9 Py. Po Zona Operative e Llapit, kur u kriju?

10 Pë. Në fillim të vitit 1998. Ajo u kriju ma herët. Ajo u
11 kriju në vitin 1995, pra, me vetëformimin e ushtrisë
12 Çlirimtare të Kosovës ka fundi i vitit 1994. Pra, ajo ka qenë
13 në fazën e gueriles atëhere. Po në aspektin e organizimit
14 ushtarak është 6 qersori i vitit 1998, pra, me daljen, pra,
15 me uniformë edhe me kazerma ashtu të improvizuara në Zaberxhë
16 të Komunës së Mitrovicës.

17 Py. Zona Operative e Llapit përveç Brigadës 151 dhe 152, a ka
18 pasë edhe ndonjë brigadë tjetër?

19 Pë. Brigada 153 është formue në shkurt të vitit 1999.

20 Py. Duke e marrë parasysh që tani i kemi tre brigada me
21 strukturë të përshtatshme në atë kohë, a kanë pasë ndarje
22 territoriale të kompetencave përkatësisht të kontrollit të
23 terreneve këto brigada?

24 Pë. Brigadat, sikur që thashë, kanë vepruar në pjesën rurale
25 dhe koncepti i, mos të them dhe doktrina, ndoshta dhe pse ka

1 qenë e pashkruar, e veprimit të Ushtrisë Çlirimtare të
2 Kosovës, nuk ka qenë me vepru në luftë urbane, por në pjesë
3 rurale. Pra, për këtë arsye, me ju përgjigj deri në pyetjen e
4 juaj, nëse marrim zonën prej Prishtine e në Podujevë ku kemi
5 qenë ma tepër të përqëndrum, aksi rrugor që shkon për në
6 Merdare, kemi nda zonën e lindjes që bie Gollaku, që ka qenë
7 edhe zona e perëndimit ku kemi vepru me dy brigadat. Zona e
8 lindjes ka vepru Brigada 153, që u formue shumë ma vonë.
9 Ndërsa në pjesën, pra, perëndimore kanë veprue dy brigadat 151
10 dhe 152.

11 Ndërsa duhet cekur këtu edhe një specifikë tonën, që kemi
12 pasë edhe BIA-n si gueril, po që ka qenë ma tepër e angazhum
13 në pjesën urbane të qytetit, pra, ma tepër për aspektet që
14 ndoshta ma vonë do t'i shpjegoj.

15 Py. Po, faleminderit. Fakti që e përmendët BIA-n, faktikisht
16 Zona Operative e Llapit është përbërë prej tre brigadave edhe
17 e përmendët BIA-n. Çfarë statusi, çfarë cilësie ka pasë BIA?

18 Pë. Sa unë e kam dëgjue dhe kam mësue dhe ndoshta dhe
19 monografia për zonën operative të Llapit, ka qenë një
20 marrëveshje e ma hershme dikun, në mos gabofsha, në shtator të
21 vitit 1997, kur, domethënë, guerilja BIA i është dhënë detyra
22 që të veprojë në zonat urbane po në aspektin e, domethënë, të
23 furnizimit apo përgatitjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
24 në zonën e Llapit për çështje të shëndetësisë, për çështje të
25 logjistikës, për çështje të pranimit të refugjatëve dhe

1 akomodimit të tyre prej zonave që kanë qenë të prekura nga
2 lufta edhe normal edhe për çështje të tjera rreth
3 informacioneve të pozicionimit të forcave të armikut edhe
4 tjera. Po kjo ishte ajo çka, pra, në këtë kohë ka veprue për
5 të gjithë kohën edhe kjo BIA.

6 Ndërsa ne kemi pasë edhe pak si plotësim edhe Mbrojtjen
7 Civile. Komandant i cili ka qenë, pra, Muhamed Latifi. E cila
8 veç është formue në të gjithë gati territorin e -- kemi fillu
9 në territorin e nënzonës së Llapit, ma vonë zonës operative të
10 Llapit.

11 Py. Ashtu siç na e shpjeguat --

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
13 kishte përfunduar përkthimi, z. Avokat.

14 Po me sa kuptoj unë, z. Dëshmitar tha që "Këto ishin
15 aktivitetet që ndërmerrete BIA". Dhe më pas në faqen 16, te
16 rreshti 13, thotë "Ne kemi patur edhe Mbrojtjen Civile". Në
17 qoftë se thoni "Ne duhet të merreshim me Mbrojtjen Civile",
18 kur thoni "ne" keni parasysh BIA-n apo keni parasysh brigadën
19 tuaj?

20 DËSHMITARI: Jo. Kam parasysh nënzonën. Tash në krahasim
21 me kohën, se një kohë ka qenë nënzonë, e mandej është bë zonë
22 operative. Flas për Zonën Operative të Llapit apo zonën e
23 Prishtinës. Nuk flas -- jo me BIA-n. Ajo, BIA është një
24 strukturë tjetër është BIA. Mbrojtja Civile është diçka
25 tjetër.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe,
2 prandaj z. Dëshmitar këtë desha të nënvijëzoj. Avokati
3 Mbrojtës ju ka kërkuar që të shpjegoni se çfarë aktivitetesth
4 ka ndërmarrë BIA. Dhe unë e kam kuptuar ose e mora vesh që ju
5 kuptuat që kjo kishte të bënte thjesht me detyrat apo me
6 detyrimet që kishte BIA. Dhe këtë pohon edhe Avokati Mbrojtës.
7 Dhe më pas ju folët, pasi shpjeguat për BIA-n, ju folët për
8 Mbrojtjen Civile, por kjo nuk ka asgjë të përbashkët me
9 aktivitetet e BIA-s. A e kam kuptuar si duhet apo jo?

10 DËSHMITARI: Mirë e keni kuptuar. Ajo është strukturë
11 tjetër. Pra, mirëpo, unë -- edhe një detyrë tjetër e BIA-s ka
12 qenë edhe, domethënë, jo rekrutimi po vullnetarët që kanë
13 dashtë --

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos
15 vazhdoni të flisni pasi unë i kam bërë pyetjen. Këtu nuk
16 flasim lirisht pa ndalesa. Në qoftë se unë ju bëj një pyetje
17 për BIA-n, aty duhet të jepni përgjigjen, të ndaloni dhe të
18 mos vazhdoni të flisni për një brigadë tjetër apo për detyrat
19 e tjera, pasi kjo është thjesht hutuese. Ju filluat të flisni
20 për Mbrojtjen Civile, e cila nuk ka asgjë të përbashkët me
21 aktivitetin e BIA-s. Dhe nuk ka nevojë t'i tregoni këtu Trupit
22 Gjykues.

23 Ne kemi një kohë të kufizuar në dispozicion këtu. Pala
24 Mbrojtëse ka përcaktuar që i duhen dy orë për dëshminë tuaj.
25 Ndërkohë që po të vazhdoni ju të flisni kaq gjatë, nuk na

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Shala

Faqe 22

1 mjafton koha. Dhe është më mirë t'i përgjigjeni pyetjes pasi
2 ashtu është dhe më mirë për të gjithë procedurën këtu.

3 DËSHMITARI: Mirë. A ka mundësi një përgjigje, pra,
4 plotësim?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Avokati Mbrojtës do t'ju bëjë një pyetje dhe ju do t'i
7 përgjigjeni pyetjes së tij. Kjo është mënyra më e mirë.

8 Avokat, ju e keni fjalën.

9 Z. SHALA:

10 Py. Z. Dëshmitar, ashtu siç e kuptova unë, zona operative e
11 Llapit, që nga muaji shkurt i vitit 1999, ka pasë tre brigada.
12 Dhe ju e përmendët BIA-n edhe e përmendët Mbrojtjen Civile.
13 Çfarë statusi kanë pasë këto të dyja, në kuadër të Zonës
14 Operative të Llapit?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Avokat, pyetja nuk është e qartë për mua. Kur thoni "çfarë
17 statusi" çfarë nënkuptoni?

18 Z. SHALA: [Përkthim] A kanë patur autoritet komandues
19 zonat operative për sa i përket BIA-s dhe/apo Mbrojtjes
20 Civile.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Dakord, do të sugjeroja që ta formuloni pikërisht në atë
23 mënyrë për dëshmitarin pasi ashtu do të jetë më e qartë.

24 Z. SHALA:

25 Py. Zona Operative e Llapit, a ka pasë ndonjë autoritet

1 komandues ndaj BIA-s dhe Mbrojtjes Civile?

2 Pë. Po edhe BIA edhe Mbrojtja Civile kanë qenë në kuadër të
3 zonës operative të Llapit, dikur nënzonës mandej Zonës
4 Operative të Llapit, apo po referoheni si zonë operative e
5 Llapit. Pra, BIA ka qenë strukturë civile, e paarmatosur. E ka
6 pasë detyrën e mbështetjes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
7 pra, nga zonat urbane. Unë nuk e përmenda dhe një detyrë që ka
8 qenë për vullnetarët që kanë dashë të kyçen në Ushtrinë
9 Çlirimtare të Kosovës, ata e kanë pasë detyrë t'i orientojnë.
10 Njëkohësisht edhe për shërbimet shëndetësore, logjistike edhe
11 çështje tjera, pra, ka qenë ma tepër si një, pra, një shërbim
12 suportues për nevoja dhe për staf, për shembull, mjekësor e
13 tjera, për nevoja të brigadave po edhe të Zonës Operative të
14 Llapit. Disa --

15 Py. Po Mbrojtja Civile çfarë detyra ka pasë?

16 Pë. Mbrojtja Civile është formue në baza territoriale, pra,
17 nëpër fshatra, bashkësi lokale edhe janë formu njësitë që kanë
18 qenë ma tepër në baza territoriale. U mobilizua atëherë kur
19 është dashtë me i mbështetë forcat, domethënë, aktive të Zonës
20 Operative të Llapit që kanë qenë të strukturime në brigada.

21 Py. Ju a keni qenë komandantë i Brigadës 151 deri në
22 përfundim të luftës?

23 Pë. Pra, sikur që thashë, diku pas mesit të gushtit e deri
24 diku ka dhjetori, mesi i dhjetorit, kam ushtru detyrën edhe të
25 komandantit të Brigadës 151, Zahir Pajaziti, po njëkohësisht

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Shala

Faqe 24

1 edhe shef i operativës së bashku me zëvendëskomandantin e
2 zonës z. Kadri Kastrati. Ndërsa, nga ajo kohë, pra, nga mesi
3 dikund pjesën, tash s'muj me u referu me kohë se -- pra, dikun
4 nga dhjetori, jam emëruar në postin e shefit të shtabit të
5 Zonës Operative të Llapit, në vitin 1998.

6 Py. A mund të na e tregoni strukturën udhëheqëse të zonës
7 operative të Llapit, shtabit?

8 Pë. Po, struktur --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila
10 është pyetja e saktë për dëshmitarin?

11 Z. SHALA: [Përkthim] Pyetja është që të na shpjegojë
12 strukturën e shtabit të përgjithshëm të zonës operative.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
14 lutem riformulojeni që të jetë më e qartë edhe për
15 procesverbalin tonë këtu.

16 Z. SHALA:

17 Py. Në kuadër të shtabit të Zonës Operative të Llapit, cilat,
18 krejt, pozita komanduese kanë ekzistuar?

19 Pë. Pra, prej nivelit të -- komandanti i zonës ka qenë
20 autoriteti më i lartë; zëvendëskomandanti; Shefi i shtabit,
21 mandej udhëheqësit e sektorëve; mandej kanë qenë udhëheqësit e
22 brigadave; edhe shërbime tjera vartëse dhe njësitet varëse.

23 Py. Me krijimin e brigadave, Brigadës 151, 152 dhe Brigadës
24 153, në kuadër të këtyre brigadave, a ka ekzistuar, a është
25 krijuar edhe policia ushtarake?

1 Pë. Po, formalisht është krijuar edhe policia ushtarake.

2 Py. Kur thuani "formalisht" çka do të thotë kjo, a nuk kanë
3 vepru?

4 Pë. Po ju kanë vepru, por janë ato kapacitetet, sikur kur
5 flasëm, na e kemi pasë brigadën, po a ka pasë në aspektin
6 kuantitativ numerik dhe kualitativ, në aspektin -- për këtë
7 arsye po e riaktivizoj edhe ato. Formalisht, çdo brigadë ka
8 pasë edhe policinë ushtarake në togun, në një nivel të togut
9 të policisë ushtarake, i cili ka pasë detyrë të mbajtjes së
10 rendit, pragut dhe rregullit ushtarak në brigadë po edhe në
11 zonë.

12 Py. Ju si komandantë i brigadës, a keni pasë autoritet edhe
13 ndaj policisë ushtarake në kuadër të brigadës?

14 Pë. Në kuptim të autoritetit po, se ato kanë qenë në kuadër
15 të brigadës. Mirëpo, ata kanë pasë detyrat e veta që sa i
16 përket rendit edhe rregullit ushtarak që është dashtë të
17 zbatojnë në kuadër të zonës së veprimit të brigadës.

18 Pë. Në kuadër të brigadës, a kanë ekzistuar rregullat strikte
19 të cilat një ushtar është dashtë t'i respekton?

20 Pë. Po. Ne nga Shtabi i Përgjithshëm kemi marrë disa prej
21 rregullave. Ndërsa për ato që s'i kemi pasë, jemi mundu t'i
22 plotësojmë vetë ne eprorët, pra, që kemi pasë njohuri apo që
23 kanë qenë profesionale në atë, me qëllim që të mos krijojmë
24 boshllëk në aspektin e rendit dhe rregullit në kuadër edhe të
25 brigadave po edhe të njësive vartëse në zonë.

1 Py. Në rast të mosrespektimit të këtyre rregullave, policia
2 ushtarake a ka pasë autoritet të ndalon këta ushtarë të UÇK-
3 së?

4 Pë. Po, ka pasë të drejtë.

5 Py. Po në kuadër të Brigadës 151, në të cilën ju keni qenë
6 komandant, a ka pasë ndonjë rast kur policia ushtarake ka
7 ndalu ushtarë?

8 Pë. Po, ka pasë me siguri. Tash nuk mund ta veçoj ndonjë
9 rast, pasi që kanë qenë kompetencë e tyre.

10 Py. Po policia ushtarake, në rast që ka ndalu ndonjë ushtar
11 për shkak të shkeljes së rregullave, a s'ka qenë i detyrume
12 t'u njofton edhe juve si komandant për një ndalim të tillë?

13 Pë. Po, sigurisht se po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Prisni. Ju po e nënkuptoni që a nuk ishte kjo -- a "nuk është
16 dhënë një njoftim ushtarak juve për këtë çështje". Ndërkohë që
17 ju po i bëni këtë -- në fakt, mund ta bëni këtë me një pyetje
18 të hapur, nuk duhet të jepni ju përgjigjen pyetjes vetë. Por
19 ta bëni si pyetje të hapur.

20 Z. SHALA:

21 Py. Në bazë të rregullave të parapara nga ana e Zonës
22 Operative e Llapit, në rast se policia ndalon ndonjë person, a
23 i raportonte për atë ndalim dikujt?

24 Pë. Ndonjë person --

25 Py. Ushtarak.

1 Pë. -- ushtarak.

2 Py. Më falni, po ushtar.

3 Pë. Po, po, sigurisht. Po i raporton. Nëse ai e ka thyer
4 rendin dhe rregullin ushtarak, ai ndërmer masa dhe ai
5 raportohet në kuadër të zinxhirit komandues, në asoçk
6 [fonetikusht]. Kjo, them, kufizojmë në kuadër të mundësive
7 çfarë i kemi pasë ne, pra, aspekteve dhe funksionale të
8 sistemit.

9 Py. Në kuadër të brigadës, a ka ekzistuar ndonjë person
10 përgjegjës i cili ka vendosë edhe për ndalimin e personit pas
11 ndalimit nga ana e policisë ushtarake dhe kohëzgjatjen e atij
12 ndalimi?

13 Pë. Po, policia ushtarake ka pasë kompetencën sikur policia e
14 rregullt mund të bëjë ndalimin e personit në kohën e caktuar,
15 domethënë, brenda kohës sikur që është parapa në rregullore.
16 Tash unë s'mund t'i referohem, pasi që realisht e kam harru
17 çështjet e konditave si i përshkruan rregullat disiplinore të
18 saj qashtu. Ashtu që edhe atëherë ju kam përmbajhtë. Edhe s'ka
19 qenë detyrimisht që unë të njoftohem permanent lidhur me
20 zbatimin e rregullores disiplinore. Nëse dikush prej ushtarëve
21 ka bë shkelje e që ka qenë në detyrë, ndoshta e ka bë ai
22 raportin e përgjithsum, po tash s'është kanë e thënë që
23 menjëherë duhet të lajmërojë komandantin e brigadës për një
24 shkelje çka mund të jetë e një niveli të ultë minore.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo

1 nuk është përgjigje për pyetjen tuaj. Jo, nuk është ashtu.
2 Pyetja ishte: A ka ekzistuar ndonjë person përgjegjës i cili
3 të vendosë për vazhdimin e paraburgimit të një personi të
4 ndaluar nga policia ushtarake? Pra, policia ushtarake ndalon
5 një person dhe më pas çfarë ndodhë? A ka një njeri që të jetë
6 përgjegjës për mbajtjen në paraburgim të këtij personi dhe
7 nëse, po, kush është ky person? Nuk bëhet fjalë këtu për
8 shkelje apo shkelje të vogla por thjesht për të gjetur
9 personin që mund të jetë përgjegjës për këtë.

10 DËSHMITARI: Nuk po flas vetëm për aspektin e ndalimit
11 policor apo ushtarak që a kanë kompetencë, ne nuk kemi pasë as
12 prokurori, as gjykata për këtë arsye unë apo përgjigja ime --

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Prisni, prisni. Nuk ka nevojë të flisni për gjërat e tjera. Ju
15 është bërë një pyetje, së cilës duhet t'i jepni përgjigje, apo
16 të na thoni jo nuk e di përgjigjen, por nuk ka nevojë që të
17 shpjegoni diçka tjetër. Po e përsëris edhe njëherë, edhe këta
18 ja them edhe palës Mbrojtëse. Kemi vetëm një kohë të kufizuar
19 në dispozicion, kështu që në qoftë se ju bëni një pyetje unë
20 pres nga ju që nga dëshmitari të merrni përgjigje, pikërisht
21 për atë përgjigjet.

22 Dhe pyetja juaj ishte shumë e qartë për të kuptuar se
23 çfarë ka ndodhur pas një ndalimi nga policia ushtarake. E shoh
24 këtë arsyen pse keni bërë këtë pyetje. Por duhet të nxirrni
25 nga dëshmitari ato përgjigje për pyetjet që ju bëni a që jeni

1 të interesuar.

2 Z. SHALA:

3 Py. Z. Dëshmitar edhe njëherë, pas veprimit të policisë
4 ushtarake në kuadër të brigadës, a ka ekzistuar një person
5 përgjegjës që ka vendosë në lidhje me arrestimin e atij
6 personi nga policia ushtarake?

7 Pë. Edhe njëherë po përgjigjem. Policia ushtarake ka pasë
8 autorizimet e veta. Dhe ka mujtë me bë ndalimin policor, tash
9 s'më kujtohet sa ka qenë ai, ka muj dy vjet. Mirëpo, nëse ka
10 qenë shkelja më e madhe, ka pasë edhe në kuadër të asaj edhe
11 komisione disiplinore që kanë vendosë për çështjen e caktuar.
12 Ashtu që nuk ka qenë çështje autoriteti të vendos për ndalim
13 apo një çështje tjetër në kuadër të saj.

14 Py. Këto komisione disiplinore, a janë krijuar *ad hoc* apo kanë
15 qenë të krijuar që më përpara? Anëtarët e komisioneve, a janë
16 emëru?

17 Pë. Ato janë formu konform rregullores disiplinore që kanë
18 qenë në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Avokat, vërej që dëshmitari nuk po i përgjigjet pyetjes suaj.

21 Ju po i bëni pyetje, ju takon juve për të bërë këtë pyetje dhe
22 unë po jua lë juve pasi nuk është detyrimi im këtu. Ne, si
23 Trupi Gjykses, mund t'i bëjmë pyetjet tona më vonë, por e
24 shohë, thjesht po vërej se çfarë po ndodh këtu.

25 Vazhdoni.

1 Z. SHALA:

2 Py. Z. Dëshmitar edhe njëherë, më intereson. Këto komisione,
3 në bazë të rregullores, po a kanë qenë komisione *ad hoc* që
4 janë kriju rast për rast apo kanë qenë komisione që janë kriju
5 ma herët që të mirren me rastet e ndalimeve policore të
6 personave të ndaluar, të ushtarëve?

7 Pë. Për çështje të ndalime, unë dhe njëherë po e cekim, kjo ka
8 qenë kompetencë e policisë ushtarake. Ndërsa për, domethënë,
9 shkeljet që kanë pasë diçka ndonjë pasojë tjetër, domethënë,
10 të rendit dhe rregullit ushtarak, kanë qenë komisionet
11 disiplinore. Tash s'më kujtohet me ju referu me raste me ato.
12 Mirëpo komisionet janë formue konform rregullores disiplinore.
13 Dhe kjo është përgjigja.

14 Py. Këto komisione, pas zhvillimit të procedurës të paraparë,
15 a kanë pasë të drejtë, në bazë të rregullores, të vendosin për
16 ndalimin e ushtarit për një periudhë më të gjatë kohore?

17 Pë. Jo, nuk kanë pasë atë kompetencë.

18 Py. E përmendët Mbrojtjen Civile. Në kuadër të brigadës,
19 Mbrojtja Civile a ka pasë obligim të raporton për gjendjen në
20 territorin e përgjegjësisë së brigadës?

21 Pë. Po Mbrojtja Civile ka veprue në baza territoriale dhe ka
22 pasë komandantin e vet. Dhe normal strukturimin e vetë. Po
23 njëkohësisht ajo është përgjegj edhe, pra, domethënë, ka qenë
24 vartëse e zonës operative.

25 Py. Mbrojtja Civile, a ka pasë autoritet që të ndalon civilë,

1 për të cilët ka dyshuar që kanë kry ndonjë veprim të

2 kundërligjshëm?

3 Pë. Po, ajo -- ka ndodhë raste kur Mbrojtja Civile ka për

4 keqbërës ka veprue dhe ka ftu policinë ushtarake për raste të

5 caktume, nëse ka pasë eventualisht ndonjë shkelje apo diçka.

6 Pasi që ne kemi qenë përgjegjës për zonat që kanë qenë, qysh

7 të them, nën mbikëqyrjen tonë.

8 Py. Pra, faktikisht po rezulton që policia ushtarake ka pasë

9 autoritet edhe për ndalimin e civilëve?

10 Pë. Po kur është paraqit rasti, kur ata kanë bë probleme edhe

11 për raste të caktuara që ka paraqit Mbrojtja Civile te

12 autoritetet e caktuara, pra, në kuadër të zonës së veprimit,

13 atëherë policia ushtarake e brigadave ka veprue dhe në ato

14 raste.

15 Py. A ka qenë e njëjta procedurë si me ushtarët dhe me

16 civilët për sa i përket ndalimit të tyre?

17 Pë. Po thujse e njëjtë ka qenë. Megjithëse prioritet i

18 policisë ushtarake ka qenë mbajtja e rendit dhe rregullit,

19 pra, në kuadër të formacioneve të strukturës ushtarake edhe të

20 UÇK-së po njëkohësisht edhe të Mbrojtjes Civile.

21 Py. Përveç policisë ushtarake, a ka pasë ndonjë autoritet

22 tjetër që ka pasë të drejtën të ndalon ushtarë apo të ndalon

23 civilë në territorin e përgjegjësisë së brigadës?

24 Pë. Po zakonisht, këta keqbërës që janë identifikue prej

25 Mbrojtjes Civile dhe ata i kanë ndërmarrë ato veprimet e para.

1 Ndërsa policia ushtarake është marrë me procesimin e tyre pra.
2 Py. A dini ndonjë rast -- a ka pasë në realitet ndonjë rast
3 që policia ushtarake ka ndalu civilë? Policia ushtarake e
4 brigadës 151?

5 Pë. Po, vetë kam qenë në një rast unë. Kur një -- kam qenë në
6 fazë të trajnimit, pra, me, them, rekrutët e rinj në Bajgorë,
7 kur një person civil ka nxjerrë armën dhe e ka a drejtue në
8 pozicionet tona, pra, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në
9 Potok. Edhe normal, ai është arrestu, është çarmatos, është
10 arretu, është sjellë. Edhe ne atë e kemi mbajtur, për shkak se
11 ai ka kërcënue direkt pjesëtarët. E ka qenë fati i tij që kanë
12 qenë këta të përmbajtur dhe nuk kanë veprue, po e kanë
13 mbizotërue, e kanë arrestue e kanë mbajtur. Ne e kemi mbajtur
14 disa ditë dhe mandej është lëshue.

15 Py. Kush ka vendos për lirimin e tij?

7 të Vendimit mbi Kryerjen e Procedurave që është parashtrim i
8 protokolluar F170.

9 Kjo përmbyll edhe urdhrin gojor të Trupit Gjykses.

10 Avokati i Mbrojtjes, fjala është për ju.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi transkript, e nderur
12 Gjykatëse.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
14 t'i kërkojmë dikujt ta shikojë këtë punë.

15 Në rregull. Më bëhet qejfi që u zgjidh kjo gjë.

16 Më lejoni të shikoj nëse punon transkripti për mua. Në
17 rregull.

18 Znj. Asistente e gjykatës, ju lutem sillni dëshmitarin.
19 Faleminderit.

20 Ndërkohë kemi rënë dakord të bëjmë një seancë 1 orë e
21 gjysmë. Kjo është për t'ju vënë thjesht në dijeni.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
24 se erdhët z. Ibishi.

25 Tani do t'ia jap fjalën z. Prokuror që të fillojë me

1 kundrapyetjet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

2 Z. Prokuror, fjala është për ju.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit të nderuar.

4 Py. Z. Ibishi, mirëdita.

5 Pë. Mirëdita.

6 Py. Si jeni?.

7 Pë. Mirë.

8 Py. Z. Ibishi, unë jam përfaqësuesi i Prokurorisë që do të
9 kryej intervistën, pjesën e kundrapyetjeve me ju. Meqë kohën e
10 kemi të kufizuar, do t'ju kërkoja që të ishit të përqendruar
11 të fokusuar në pyetjet e mia, t'i përgjigjeni drejtpërdrejtë
12 pyetjes sime. Nëse bëni ndonjë koment apo devijoni nga pyetja,
13 do të më duhet t'ju ndaloj edhe do t'i rikthehem edhe njëherë
14 pyetjes në fjalë. Kjo është thjeshtë të jemi sa më të kufizuar
15 edhe sa më të përqendruar në pjesën e kundra pyetjeve për hir
16 të kohës, z. Ibishi.

17 E kuptoni apo jo? Duhet të thoni po ose jo, se thjeshtë
18 me pohim me kokë nuk e kup--.

19 Pë. Po.

20 Py. Do doja të qartësoja me ju z. Ibishi, disa pika të vogla
21 lidhur me dëshminë që keni dhënë sot. Do doja të filloja me
22 faqen 53, rreshti 8 i transkriptit të ditës së sotme. Ju aty
23 keni përmendur personin që kishte nofkën Korabi. E mbani mend
24 që përmendët personin me nofkën Korabi?

25 Pë. Po.

1 Py. A mund të na tregoni i kujt është kjo nofkë, mund të na
2 jepi emrin dhe mbiemrin e Korabit? Kujt i përkiste kjo nofkë?

3 Pë. Kapllan Parduzi.

4 Py. Sot paradite folëm për transportimin tuaj drejt spitalit
5 të UÇK-së në Potok. E mbani mend këtë? Në faqen 42, rreshti 2
6 dhe përfundon në faqen 49, rreshti 8. Të kujtohet që folëm për
7 transportin tuaj dhe të Korabit?

8 Pë. Po.

9 Py. Faleminderit. Kur po diskutonim për këtë rrugëtim, juve
10 ju pyetën për personin apo personat që ju shoqëronin gjatë
11 këtij udhëtimi, gjatë këtij rrugëtimi. Dhe thatë, në faqen 47,
12 rreshti 7 dhe 8, thatë si në vijim:

13 "Dhe Latif Gashi ishte po ashtu afër, i cili ndërmoi
14 masat e sigurisë".

15 E konfirmoni këtë z. Ibishi?

16 Pë. Po.

17 Py. A mund t'i thoni Trupit Gjykses cila ishte pozita e Latif
18 Gashit në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës asokohe?

19 Pë. Ishte shef i zbulim-kundërzbulimit në kuadër të Zonës
20 Operative të Llapit.

21 Py. E ke fjalën brenda komandës së Zonës Operative të Llapit,
22 këtë nënkupton?

23 Pë. Po.

24 Py. Z. Ibishi, Latif Gashi, a kishte ndonjë nofkë apo
25 pseudonim gjatë luftës?

1 Pë. Lata, po. Apo Fati.

2 Py. Z. Ibishi, a ju kujtohet deklarata që i keni dhënë
3 Mbrojtjes në 20021, për këtë çështje?

4 Pë. Po. Ndoshta s'mund me e kujtu krejt, por ndoshta pjesë.

5 Py. Kemi një kopje të deklaratës suaj, është 28 maj 2021 data
6 e deklaratës. Kur keni dhënë deklaratën z. Ibishi, a i keni
7 thënë të vërtetën palës Mbrojtëse?

8 Pë. Duhet ta them të vërtetën.

9 Py. A përshkruat ngjarjet që rrodhën, pra me aq sa besonit ju
10 që mbanit mend?

11 Pë. Po mendoj. Veç nëse më ka mbet pa e përmend, përndryshe
12 s'kam pas arsye mos me e tregu të vërtetën.

13 Py. A e nënshkruat deklaratën z. Ibishi?

14 Pë. Po.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen e të nderuarve
16 Gjykatës, do t'i kërkoja z. Sekretar të Gjykatës, të vendosë
17 në ekran deklaratën e Mbrojtjes DSM00460 deri 00475, faqja 8.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
19 lutem, vendosni deklaratën, z. Sekretar i Gjykatës.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Rreshti fillon me fjalët "Latif
21 Gashi", aty fillon. Ku përgjigja fillon me Latif Gashi. Është
22 e dukshme. Është shkurtimisht para pyetjes tjetër.

23 Py. Z. Ibishi, në këtë deklaratë që i keni dhënë Mbrojtjes
24 keni thënë si në vijim:

25 "Latif Gashi ishte përgjegjës që të shikonte rreth e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 69

1 rrotull dhe ne eventualisht u evakuuam dhe u transportuam për
2 në spital".

3 A e keni thënë këtë z. Ibishi?

4 Pë. Po. Veçse, më fal, a ka mundësi versionin shqip?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 Dëshmitar, pse do të shikosh versionin shqip. U përkthye.

7 DËSHMITARI: A ka mundësi...

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

9 lejoni të mbaroj, ju lutem. Ne kemi anglishten këtu dhe iu
10 përkthye kjo fjali në shqip. Në versionin shqip nuk besoj se
11 ka gjë ndryshe nga ajo që është shkruar këtu.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 Py. Thelbi i pyetjes sime në fakt, z. Ibishi, ishte a e
14 konfirmoni ju që Latif Gashi ishte përgjegjës që të shikonte
15 rreth e rrotull, të kontrollonte terrenin gjatë udhëtimit? A
16 ishte përgjegjës, kjo ishte thelbi i pyetjes sime, siç i keni
17 thënë Mbrojtjes?

18 Pë. A ka mundësi edhe njëherë të ma përktheni këtë në shqip.
19 Unë e kuptoj anglishten, por jo --. Vetëm këtë fjali, kështu.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
21 është përkthyer në shqip. Megjithatë do t'i kërkoj z. Prokuror
22 nëse mund ta citojë tekstin siç thuhet këtu, siç thuhet fjalë
23 për fjalë në deklaratën e dëshmitarit, në mënyrë që ta
24 përkthejë përkthyesi.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 Py. Kjo pjesa këtu lidhet me udhëtimin tuaj nga Turiqica

2 drejt Potokut. Dhe ju thoni:

3 "Latif Gashi ishte përgjegjës të shikonte rreth e rrotull
4 dhe eventualisht përfundimisht u evakuam dhe u transportuam
5 drejt spitalit".

6 A i keni thënë të vërtetën Mbrojtjes me këtë fjali?

7 Pë. Po.

8 Py. Në rregull. Faleminderit.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim tekstin atëherë.
10 Do të doja t'i tregoja dëshmitarit një dokument tjetër që i
11 përket të njëjtës temë, të njëjtit aspekt.

12 Nëse mundem, z. Sekretar i Gjykatës, do të doja t'i
13 tregoja dëshmitarit një deklaratë tjetër që është regjistrimi
14 i dëgjimit të dëshmitarit para gjykatësit hetues, dëshmitari
15 Nuredin Ibishi, Hep, No. 65/2002, Latif Gashi dhe të tjerë,
16 Gjykata Themelore e Prishtinës, 27 gusht 2002. Mban numrin
17 rendor SPOE00131650 [sipas përkthimit] deri në 00123574. Do
18 t'i tregoja dëshmitarit faqen 12 me numrin rendor
19 SPOE00123571, faqe 12.

20 Py. Z. Ibishi, kjo është deklarata që ju keni dhënë para
21 gjykatësit hetues në çështjen Latif Gashi dhe të tjerë. Në
22 faqen 12 të së cilës, gjendet pyetja dhe përgjigja pasuese.

23 Gjykatësi hetues:

24 "Me sa kuptoj unë nga dëshmia juaj e mëparshme, ju jeni
25 plagosur në muajin maj"?

1 Dhe ju u përgjigjët:

2 "Jo, unë jam plagosur më 9 prill dhe 2 apo 3 ditë më vonë
3 më dërguan në spitalin ushtarak të Potokut me ndihmën e Latës
4 dhe bashkëluftëtarëve të tij".

5 Po ndaloj këtu. A e konfirmoni që ia keni deklaruar këtë
6 gjykatësit hetues?

7 Pë. Me siguri, se e kam nënshkruar. Me siguri, po.

8 Py. Pra, a është e vërtetë që ishte Lata ai që ju ka ndihmuar
9 gjatë transportimit apo kalimit nga Turiqica në Potok?

10 Pë. Po.

11 Py. Përgjigja këtu përmend nofkën, Lata. Ju i thatë më parë
12 Trupit Gjykues që Lata është nofkë e Latif Gashit, a e keni
13 fjalën për Latif Gashin në këtë pjesë të deklaratës suaj?

14 Pë. Po. Po.

15 Py. Z. Ibishi, po ndërroj pak temë për të diskutuar pak
16 lëndimet tuaja. Ju përmendët sot që kjo ndodhi gjatë një
17 beteje. A mund t'i tregoni hollësi të mëtejshme Trupit Gjykues
18 lidhur me lëndimet tuaja sa të rënda kanë qenë e të tjera?

19 Pë. Po. Kanë qenë lëndime të rënda, ashtu siç i kanë trajtuar
20 mjekët. Nuk është çështje e imja. Tjetër, jam plagosur nga një
21 armë që me konventa ndërkombëtare është e ndaluar. Ka të bëjë
22 me pragën 30 milimetra, që e ka efektin sekondar, domethënë
23 përveç goditjes direkt ka projektimin eksploziv. Dhe nga ajo
24 shkakton pasoja të rënda dhe sidomos ka shkakuar tek civilët.
25 Edhe në këtë rast tek unë dhe bashkëluftëtari im Korabi. Për

1 këtë arsye them se lëndimet janë të karakterit të rëndë.

2 Py. Na thatë që këto plagë ishin të rënda. Cilët ishit këto
3 plagë, na shpjegoni ekzaktësisht ku i morët këto plagë, në
4 cilën pjesë të trupit. Cilat pjesë të trupit janë dëmtuar nga
5 këto municione?

6 Pë. Dy shpime i kam në stomak. Dhe në pjesën e mbrapsmë në
7 pjesën e shpinës, i kam ende mbetjet nga fragmentet e
8 eksplozimit. Gjithashtu edhe këtu në vesh e kam një copë
9 fragmenti të eksplozimit, të projektimit në të vërtetë të
10 pragës.

11 Py. Siç e thatë, mjekët e trajtuan si serioze çështjen tuaj,
12 kështu është?

13 Pë. Po.

14 Py. Në faqen 52 të transkriptit, rreshtat 7 deri në 11, ju
15 sot folët për plagët që kishte pësuar Kapllan Parduzy, Korabi
16 dhe po jua lexoj. Ju thatë si më poshtë:

17 "...Kapllan Parduzy ishte dëmtuar më rëndë, për shkak se
18 në atë kohë nuk ishte e mundur që të bëheshin operacionet e
19 tjera dhe filluan t'i dëmtoheshin më tej plagët, t'ju vinte
20 erë dhe të bëheshin më septike. Pra, situata për të ishte
21 kritike që atij t'i sigurohej trajtim i mëtejshëm".

22 A e thatë një gjë të tillë?

23 Pë. Po, e thashë.

24 Py. Me sa kuptoj unë, gjendja e z. Parduzy ishte më e keqe se
25 sa e juaja. Kështu po thoni?

1 Pë. Po.

2 Py. A mund të na tregoni, nëse i kthehemi përsëri momentit të
3 transportimit tuaj nga Turiqica në Potok, mundohuni që ta
4 sillni në mendje këtë moment. A mund të na tregoni se në çfarë
5 gjendje ishte z. Parduzi gjatë rrugës së transportimit? A mund
6 të na tregoni se çfarë mbani mend?

7 Pë. Po them, të dy ishim në gjendje të rëndë. Tash për të ba
8 krahasimin se cili është rëndë e më rëndë, aty nuk mund të kem
9 një vlerësim unë. Vetëm po them se ai ka qenë në gjendje më
10 rëndë se unë. Të dy kemi qenë në gjendje jashtëzakonisht të
11 rëndë, për arsye se po të mos shkonim në kohë në spitalin
12 ushtarak edhe të mos i nënshtroheshim operacionit, do të vinte
13 deri tek sepsa. Kjo ishte. Por, përkundër nënshtrimit të
14 operacionit që u bë pas dy ditëve udhëtim, siç folëm, në
15 spitalin ushtarak në Potok, tek ai u ngadalësua aspekti i
16 shërimit në të vërtetë i trajtimit. Dhe për këtë arsye po them
17 që ndoshta gjendja e tij, prej dy gjendjeve të rënda ai e ka
18 pas më të rëndë. Kështu mund të them përkufizimin.

19 Py. Nuk dua të flas për shërimin e tij më vonë, jam i lumtur
20 që është shëruar në fakt. Por e kam fjalën për këtë udhëtim,
21 nga Turiqica në Potok. Kjo ishte pyetja ime. Ndoshta po e bëj
22 në mënyrë më të posaçme.

23 A e dini se çfarë ka marrë Kapllan Parduzi, Korabi?

24 Pë. Tash unë nuk jam mjek t'jua shpjegoj lidhur me trajtimin.
25 Mirëpo ka lëndime dhe ka probleme të vazhdueshme të brendshme.

1 Aktualisht ende nuk është në aspektin e riparimit, sikurse
2 edhe unë. Tash unë s'jam mjek me jua tregu shkallën. Se ne të
3 dy jemi invalidë. E kuptoni? Jemi invalidë të kategorizuar.

4 Për këtë arsye është në peshë mes njëri dhe tjetrit se sa
5 është shkalla e invaliditetit. S'po kuptoj as pse kjo çështje
6 juve në çfarë aspekti --. Po më duket fyese ose është dash me
7 i sjell fotografitë me ju tregu se çfarë ka qenë operacioni. I
8 kemi fotografitë e operacionit e me pa ju gjendjen çfarë ka
9 qenë. Po mendoj kjo është sinqerisht, a din --. S'po kuptoj
10 fare. Kjo po më ndikon integritetin tim. Tash mua po bie një
11 situatë. Të lutem. Jo, por s'ka kurrfarë kuptimi kjo.

12 Py. Z. Ibishi, mendoj ta bëj të qartë. Nuk po i vë në
13 pikëpyetje dëmtimet apo se sa të rënda kanë qenë plagët tuaja,
14 apo të z. Parduzi. Dua që ju t'i tregoni Trupi Gjykues se
15 çfarë ju kujtohet nga ai udhëtim. Ju ishit këtu në këtë
16 rimorkio dhe i thatë Trupit Gjykues që ishit i shtrirë gjatë
17 asaj kohe. Kështu është?

18 Pë. Zotëri, ne kemi qenë të shtrirë në gjendje shumë të
19 rëndë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Dëshmitar.

22 DËSHMITARI: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Askush nuk dëshiron t'ju ofendojë juve. Unë jam këtu për ta
25 kontrolluar këtë proces, për të bërë të mundur që të gjithë në

1 këtë sallë gjyqi të trajtohen me respekt dhe nuk do të lejoj
2 mungesë respekti. Dhe mund t'ju siguroj, në këtë rast pyetja e
3 bërë është objektive dhe synon nxjerrjen e një informacioni të
4 caktuar.

5 Kështu që do t'ju lutesha që t'i përgjigjeshit pyetjes.
6 Ne do të përpiqemi të mos trajtoheni në mënyrë të
7 parespektshme, pra dhe kjo nuk është një situatë e mungesës së
8 respektit. Është thjesht një rast ku kërkohet të nxirret një
9 informacion i caktuar. Nuk ka nevojë që të komentojmë për këtë
10 çështje.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

12 Py. Nga përgjigjet që ju dhatë sot, unë e kuptova që ju vetë
13 ishit i shtrirë gjatë këtij udhëtimi nga Turiqica në Potok.
14 Kështu është?

15 Pë. Unë dhe Korabi kemi qenë të shtrirë dhe në gjendje shumë
16 të rëndë. Unë s'po di si me e shpjegue ndryshe. Edhe kishim në
17 prezencë dhe në vazhdimësi trajtimin mjekësor nga personeli
18 mjekësor. S'po di si me ju tregue. Ose është dashtë me na lënë
19 diku edhe me vdek aty. Unë s'po kuptoj sinqerisht kjo --. Znj.
20 Kryetare unë po mendoj kjo është diskriminuese, në kuptim të
21 qasjes.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Ibishi, të lutem. Ju lutem ndaloni.

24 DËSHMITARI: Mirë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

1 ka arsye për të bërë këto komente lidhur me atë që tha z.

2 Prokuror.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

4 Py. Z. Ibishi, unë nuk desha t'ju ofendoj. Thjesht pyeta për
5 pozicionin në të cilin ndodheshit në atë kohë.

6 Pë. Unë e mora për ofendim.

7 Py. Nuk kisha këtë ndërmend, z. Ibishi. Mund t'ju bëj një
8 pyetje: Në çfarë pozicioni ishte z. Kapllan Parduzi gjatë atij
9 udhëtimit?

10 Pë. S'po di, se ka qenë transport i gjatë. Unë tash, për
11 komfortitet është dash unë të qëndroj, them për shkak të --.
12 Të gjithë kemi qenë në stomak të plagosur. Edhe është dash me
13 marrë pozitën që dhimbjet të jenë më pak. Edhe kemi marrë
14 qetësues për shkak të dhimbjeve të vazhdueshme. Edhe tash, unë
15 nuk jam specialist t'ju shpjegoj se çfarë ka qenë ai niveli i
16 asaj tek ju kam nënshtuar. Është dash t'ia u sjell fotografitë
17 e t'i shihni, se i kemi. Nëse i don Trupi Gjykes, mund t'i
18 sjellim edhe fotografitë. T'i shihni se çfarë ka qenë, çfarë
19 ndërhyrje e operacionit, atëherë me e pa se në çfarë gjendje
20 kemi qenë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Ibishi. Unë do të dëshiroja që ju thjesht t'i përgjigjeshit
23 pyetjes. Kaq po kërkojmë. Po të dëshironim të shihnim
24 fotografitë, do t'jua kishim kërkuar t'i sillnit.

25 DËSHMITARI: Po.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

2 Py. Z. Ibishi, a ka qenë i mbështjellë me garza z. Paduzi
3 gjatë këtij udhëtimi? Në trupin e tij?

4 Pë. Me siguri, po. Ai edhe unë.

5 Py. A keni parë se në cilat pjesë të trupit i ka pasur këto
6 garza ai?

7 Pë. Tash, a i kam pa? I kam pa, ka qenë krejt në stomak me
8 fasha. Ndërsa unë kam qenë gjithashtu me fasha, plus edhe në
9 vesh e kam pas për shkak që më rridhte gjaku, por edhe poshtë.
10 Të gjithë kemi qenë në vazhdimësi duke humbur gjak, përveç
11 çështjeve të tjera, dhimbjeve dhe mundësisë së krijimit të
12 sepsit për arsye se ka të bëj me lëndimin e organeve të
13 brendshme të stomakut. S'di a jam i qartë.

14 Py. E kuptoj. Z. Ibishi, a ka pasur Kapllan Parduzi ndonjë
15 fashë apo ndonjë garzë, në kokë?

16 Pë. Nuk më kujtohet.

17 Py. Sot, në këtë gjyq - dhe kjo gjendet në faqen 47 rreshtat
18 8 deri në 11 - ju thatësi më poshtë lidhur me këtë udhëtim
19 nga Turiqica në Potok, dhe po citoj përgjigjen tuaj:

20 "Unë nuk shihja dot jashtë për shkak se rimorkio ishte e
21 mbuluar me një plastikë për shkak të kushteve të motit. Binte
22 shi gjatë gjithë kohës".

23 A e konfirmoni këtë?

24 Pë. Po.

25 Py. Po e ndryshoj për një çast temën për të diskutuar

1 formacionet ushtarake në Zonën Operative të Llapit. Sot ju na
2 treguat lidhur me Brigadën 151, kështu është?

3 Pë. Po.

4 Py. Ju na treguat që brigada tjetër ishte 152 dhe e treta
5 ishte 153, kështu është?

6 Pë. Po. Vetëm diferencë kohore 153 në formim, nëse.

7 Py. Na treguat më herët që Brigada 153 është krijuar në
8 shkurt të 1999, në qoftë se e mbaj mend si duhet, kështu
9 është?

10 Pë. Po, ashtu.

11 Py. Mbrojtja ju ka bërë disa pyetje lidhur me BIA-n. A ju
12 kujtohen pyetjet dhe përgjigjet lidhur me BIA-n? Lidhur me
13 këtë njësi?

14 Pë. Posi.

15 Py. Dëshiroj të sqarojmë disa gjëra lidhur me këtë njësitin
16 BIA. A ishte BIA nën vartësinë e komandës së Zonës Operative
17 të Llapit?

18 Pë. Po.

19 Py. A raportonte tek komanda e Zonës Operative të Llapit,
20 BIA?

21 Pë. Po është dash të raportonte. Por që realisht për shkak të
22 largësisë në krahasim me vendndodhjen edhe të komandës së
23 zonës, por edhe të shtabit edhe pamundësinë që ne të
24 qarkullojmë në pjesën urbane, kështu e kishim të ndaluar për
25 shkak që vetëm na kishin identifikuar ne eprorëve që ishim me

1 uniformë në Zonën Operative të Llapit, ne e bamë ndalimin e
2 rreptë të udhëtimit. Mbasi na pësuan 5 luftëtarëve tanë, nëse
3 doni të përmendim emrat, që u vranë në Prishtinë nga forcat
4 policore serbe, që do të thotë që mundësia jonë për të
5 udhëtuar në zonat urbane ka qenë rreptësishtë e ndaluar. Dhe
6 vetë koncepti i angazhimit tonë, nuk kemi dashur të hapim
7 konflikt në zona urbane për shkak të represionit të forcave
8 serbe ndaj popullatës. Për këtë arsye po them, edhe largësia
9 gjeografike, edhe çështja e pamundësisë të hyrjes në zona
10 urbane, nuk kemi pas këmbim të raporteve apo edhe dhënieve të
11 urdhrave, përveç rasteve kur kemi pas nevojë për shërbime nga
12 ata.

13 Py. Nuk po sugjeroj që ju si anëtarë të komandës së Zonës
14 Operative të shkonit në Prishtinë për të biseduar me BIA-n,
15 por ndoshta e kundërta, që anëtarët e BIA-s të vinin tek ju
16 për të raportuar tek komanda e zonës operative. A ka ndodhur
17 një gjë e tillë apo jo?

18 Pë. Po me siguri ka ndodhur, mirëpo unë s'kam pas rastin.
19 Përveç rastit që përmenda më herët që kam pas një kontakt të
20 rastit. Tash edhe nuk jam i sigurt a ka qenë ai anëtar i BIA-
21 s, pasi që ai ka mund të ketë raporte me dikë prej stafit të
22 komandës. Edhe sikur thashë, kur BIA ka ofruar shërbime për
23 nevoja shëndetësore, për nevoja të personelit, për nevoja të
24 logjistikes dhe për çështje ashtu siç ka qenë e nevojshme në
25 aspektin e komunikimit të drejtë me mua apo me dikë prej

1 komandës të caktuar, përveç asaj shërbimeve specifike që ka
2 kryer BIA për nevoja të Zonës Operative të Llapit.
3 Py. Të sqarojmë një gjë. Sot ju përmendët që keni kontaktuar
4 një person i cili mund të ishte nga BIA dhe thatë që emri i
5 tij ishte Rrahman Dini, kështu është?

6 Pë. Ashtu është.

7 Py. Me sa dini ju, a ka ardhur ndokush tjetër nga BIA gjatë
8 kohës së luftës që të raportonte para jush?

9 Pë. Para meje, jo. Mirëpo, ka raportu, por ka kryer shërbime
10 për nevoja, sikur që thashë, të shërbimeve të ndryshme në
11 kuadër të zonës operative të Llapit. Dhe ato tash mos i
12 përmendi ato çka i thashë pak më parë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] z.
14 Prokuror. Më vonë a mund të na jepni referencën lidhur me
15 Rrahman Dinin që ndodhet në transkriptin e ditës së sotme?

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do ta bëj sapo të kem mundësinë
17 e parë, të nderuar Gjykatës.

18 Py. Nga kush i merrnin urdhrat anëtarët e BIA-s?

19 Pë. Ata i kanë pas të përshkruara detyrat e tyre. Se ata kanë
20 filluar veprimin edhe pa filluar formimi ushtarak i zonës. Ata
21 më herët kanë filluar në bazë të një marrëveshje që sikurse
22 dihet, mes Komandant --.

23 Py. Ju kërkoi ndjesë që po ju ndërpres. Duhet të jemi pak më
24 të saktë. Se dua të kuptoj situatën. Le të flasim për 1999,
25 nga janari deri në fund të konfliktit. Nga kush i merрте

1 urdhrat BIA gjatë kësaj periudhe kohore?

2 Pë. Po ajo s'ka pas nevojë të marrë urdhra. Ajo ka kryer
3 shërbime sipas nevojës që ka pas zona. Ajo ka qenë një
4 strukturë civile e paarmatosur e cila ku është treguar nevoja
5 shërbime të caktuara, kanë ba kërkesë tek komandanti i
6 njësitit BIA dhe ai i ka shërbyer.

7 Py. Si quheshin kryetarët e zonës të cilët i jepnin urdhra
8 BIA-s?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Mendova që tha "kërkesa".

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

12 Py. Atëherë, nuk po përmend fjalën "urdhë", por po them tani
13 kush në zonën operative të Llapit i bënte kërkesat në drejtim
14 të BIA-s në atë periudhë kohore? Kush nga ata?

15 Pë. Për shembull, Skënder Murati ka qenë shef i sektorit të
16 shëndetësisë. Ai ka pas nevojë për personelin mjekësor nga
17 Prishtina, ka pas nevojë për medikamente, ka pas nevojë edhe
18 për mjete ndoshta transportuese për aty. I logjistikës ka qenë
19 Hamit Hamiti, Bali. Edhe ai ka ba kërkesën për nevoja të
20 caktuara për nevoja të logjistikës. Mandej, për çështje të
21 personelit nëse ka pas nevojë diçka për ndonjë kërkesë të
22 qytetarëve për lajmërim vullnetar në Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës, atëherë BIA i ka mbështetur pasi që ka qenë strukturë
24 civile e paarmatosur dhe mundësia a saj për të njohur terrenin
25 edhe në pjesën urbane, por edhe në pjesë rurale me i orientue

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 82

1 në Zonën Operative të Llapit, gjegjësisht në shërbimin e
2 caktuar.

3 Py. A ka marrë ndonjë urdhër apo kërkesë nga ana juaj
4 personalisht?

5 Pë. Jo. Asnjëherë.

6 Py. A ka raportuar ndonjëherë për aktivitetet e saj para jush
7 BIA?

8 Pë. Jo. Ndoshta pas lufte kemi qenë në kontakt të
9 vazhdueshmen. Pasi që vendi u çlirua dhe atëherë kemi pas
10 kontakt të vazhdueshëm. Mirëpo, për kohën e luftës, nuk kam
11 marrë ndonjë kërkesë specifike prej BIA-s.

12 Py. Gjatë luftës, Salih Mustafa ka raportuar para jush? Dhe
13 ndoshta mund ta kufizojmë këtë për periudhën nga janari deri
14 në qershor të 1991? Pra, a ka raportuar Salih Mustafa para
15 jush gjatë kësaj kohe?

16 Pë. Jo, nuk ka raportuar. Përveç kur jam pa në qershor të
17 vitit -- me çlirimin e Kosovës, atëherë kur jam pa në vendin e
18 shtabit në Kolovicë të Re.

19 Py. A i keni lëshuar ndonjë urdhër ju Salih Mustafës?

20 Pë. Jo.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju do
22 ta merrni fjalën kur të keni kohë. A e keni këtë për tematikën
23 e pyetjeve? Pasi në qoftë se është ky rasti, atëherë do t'i
24 kërkojmë dëshmitarit që të dalë jashtë. Kështu është? Nuk di
25 çfarë doni të thoni.

1 Z. SHALA: [Përkthim] Është një gabim, ishte për qershor
2 të 1991.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Doja të thosha për 1999.

4 Z. SHALA: [Përkthim] Është faqja 71, rreshti 17.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit Avokatit që e bën këtë.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jam shumë mirënjohës kolegut
8 tim. Dhe e dyta do të jepja referencën për z. Rahman Dini që
9 është në faqen 28, rreshti 24. Dhe faqja 41, rreshti 1. Këtu
10 në këtë pjesë është diskutuar Rrahman Dini.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit, z. Prokuror.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

14 Py. Po i kthehem edhe njëherë pyetjes sime të fundit. Pyetja
15 e fundit që ju bëra juve z. Ibishi ishte:

16 "Nëse ju vetë i kishit dhënë ndonjë urdhër z. Salih
17 Mustafa"?

18 Dhe përgjigja juaj ishte:

19 "Jo".

20 A e konfirmoni që kështu është?

21 Pë. Po. Nuk kam dhënë urdhër. Po t'i kisha dhënë me siguri--.

22 Kjo pyetje është këtu? Nëse ndonjëherë?

23 Py. Po, po. Ajo ishte pyetje.

24 Pë. A i kam dhënë urdhër? Apo po t'i kisha dhënë urdhër, e
25 kishte kry? S'po kuptoj.

1 Py. Pyetja ishte e thjeshtë. Unë ju pyeta nëse ju vetë --. Po
2 i kthehem edhe njëherë pyetjes. Ju vetë, a i keni dhënë urdhra
3 Salih Mustafës? Kjo është pyetja. Cila është përgjigja ndaj
4 kësaj pyetje dhe e kam fjalën për periudhën nga janari deri në
5 qershor të 1999, pra gjatë kohës së luftës.

6 Pë. Në qershor me e kufizue tash. Në qershor pas çlirimit të
7 Kosovës, unë mund të kontaktoj me të direkt, nuk kam nevojë.
8 Se jemi bashke në Kolovicë të Re. E tash veç ky kufizim të mos
9 keqkuptohet mandej. Gjatë kohës së luftës, a ka mundësi ky
10 kufizim?

11 Py. Deri në qershor.

12 Pë. Në rregull jemi.

13 Py. Pra, gjatë kohës së luftës ju nuk keni lëshuar ndonjë
14 urdhër në drejtim të Salih Mustafaës, apo jo? Të
15 drejtpërdrejtë?

16 Pë. Jo, jo.

17 Py. Sot na thatë që komandanti i BIA-s ishte Salih Mustafa.
18 Faqe 35, rreshtat 10 deri në 12. Kështu është?

19 Pë. Po.

20 Py. Si e keni ditur që Salih Mustafa ishte komandanti i BIA-
21 s? Si e dinit një gjë të tillë?

22 Pë. E kanë ditur të gjithë. Salih Mustafa, Cali është një
23 veprimtar i njohur i çështjes kombëtare. Ka qenë i angazhuar
24 edhe në lëvizjen për liri të mëhershme, ka qenë edhe i
25 burgosur politik edhe normal i organizuar në njësitin BIA.

1 Edhe pse s'e kam njohur personalisht, kam pas njohuri lidhur
2 me veprimtarinë dhe aktivitetet e tija.

3 Py. E kuptoj. Ju sapo thatë që nuk e njihnit personalisht.

4 Dhe në faqen 35 të transkriptit të ditës së sotme, rreshtat 13
5 deri në 16, ju thatë të njëjtën gjë:

6 "Nuk e njihnit personalisht. Ju dinit lidhur me rolin e
7 tij dhe me postin apo pozicionin e tij".

8 A nënkupton kjo që gjatë luftës ju vetë nuk e keni takuar
9 Salih Mustafën?

10 Pë. Ndoshta e kam takuar, por s'e kam njohur. Një person
11 mundesh me e taku kalimthi, mirëpo duke pas parasysh se nuk e
12 kam njohur më herët, atëherë personalisht veç mund të them që
13 s'e kam njoh. Kam mund ndoshta me e pa edhe me kalu duke --
14 mos me e njoh ma herët, duke mos pas ndonjë njohuri të them
15 personale me të.

16 Py. E kuptoj, shumë e qartë. Faleminderit z. Ibishi.

17 Z. Ibishi, më 19 nëntor të vitit 2019, i dhatë deklaratën
18 Zyrës së Prokurorit të Specializuar, e mbani mend?

19 Pë. Të cilit vit?

20 Py. 2019.

21 Pë. Po.

22 Py. Në atë deklaratë, a thatë të vërtetën, a i treguat të
23 vërtetën Prokurorisë?

24 Pë. Unë çdo herë mundohem ta them të vërtetën.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja

1 të përmendja një deklaratë tjetër. Pyetjet e mija janë të
2 vlefshme, mund ta them më vonë deklaratën. Por tani do të flas
3 për një deklaratë tjetër.

4 Py. Po flas tani për deklaratën e ZPS-së. Po thoni që i thatë
5 të vërtetën Prokurorisë, apo jo?

6 Pë. Po.

7 Py. A ju ushtruan ndonjë farë presioni, a ju detyruan, a ju
8 kanosën kur i dhatë këtë deklaratë Prokurorisë? Apo e dhatë
9 vullnetarisht këtë deklaratë?

10 Pë. S'po di kur e kam dhënë këtë deklaratë. Se kemi pas --
11 kjo është procesi apo gjykata e pestë ndaj krimeve të
12 pretenduara ndaj nesh. Dhe tash realisht s'po mund as me dit
13 ndaj cilës gjykatë dhe cilit gjykatës e keni fjalën?

14 Py. Jo. Flas për Zyrën e Prokurorit të Specializuar, pra zyra
15 e jonë në këtë çështje.

16 Pë. Mendoj se po.

17 Py. A u ushtrua ndonjë trysni ndaj jush, a ju detyruan, a ju
18 kanosën apo e dhatë vullnetarisht këtë deklaratë?

19 Pë. Jo. Vetëm se ka mund me qenë çështje e lodhjes apo diçka.
20 Përndryshe s'kam pas asnjë kanosje dhe nuk i drojë askujt.

21 Py. Do flas pak më vonë për deklaratën e Prokurorisë.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Por përpara me lejen e Trupit
23 Gjykues, do të doja t'i tregoja dëshmitarit deklaratën e ZPS-
24 së të Salih Mustafës në fakt, deklaratën që Salih Mustafa i ka
25 dhënë zyrës sonë më 19 nëntor 2019. Numër 069404-TR-ET, Pjesa

1 1, faqja 24. Këtu flitet për marrjen dhe dhënien e urdhrave.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faqja 24.

5 Py. Z. Ibishi, do të doja të dëgjonit me vëmendje çfarë ka
6 thënë Salih Mustafa, i akuzuari, në këtë çështje. Çfarë ka
7 thënë për marrjen e urdhrave. Nga rreshti 1 deri në 8. Ai ka
8 thënë:

9 "S'e mbaj mend saktësisht. Mund t'ju them me kë takohesha
10 për të marrë urdhrat".

11 Këtë ka thënë z. Salih Mustafa. Pyetja ishte:

12 "Po".

13 Dhe përgjigja ishte:

14 "Merrnim urdhrat nga shtabi i nënzonës".

15 Pyetja ishte:

16 "Kush ishte? Ju përmendët Rustem Mustafën".

17 Përgjigja:

18 "Rustem Mustafa, Kadri Kastrati".

19 Pyetje:

20 "Nuredin"?

21 Përgjigja:

22 "Nuredin Ibishi".

23 Do të doja t'ju tregoja edhe një pjesë tjetër të së
24 njëjtës deklaratë të Salih Mustafës. Lidhur me të njëjtën temë
25 sa u takon urdhrave. Megjithatë kjo është një pjesë tjetër.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jemi në të njëjtën numër rendor
2 ERN 069404-TR-ET, Pjesa 5. Nëse mund t'i kërkoj z. Sekretar të
3 Gjykatës të na e shfaqë në ekran.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Atëherë do të rekomandoja t'i hapni të dyja deklaratat.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, mund t'i hapim të dyja
7 deklaratat njëkohësisht. Pjesa 5, faqja 22. Dhe doja të shkoja
8 në fund të faqes dhe do të vijojmë pastaj me deklaratën në
9 faqen 23.

10 Py. Z. Ibishi, më dëgjoni me vëmendje se çfarë ka thënë z.
11 Salih Mustafa për dhënien dhe marrjen e urdhrave.

12 Pyetje:

13 "Personi në komandën e zonës që shpërndante këto rregulla
14 juve, a e mbani mend kush ishte ky person"?

15 Përgjigje:

16 "Nëse nuk e kam gabim, i merrja nga drejtorja e
17 operativës, sektorët, sepse ata ishin përgjegjës me rregullore
18 dhe gjëra të tilla".

19 Pyetje:

20 "Për kë po flet konkretisht? Cili brenda divizionit
21 operativ"?

22 Përgjigja:

23 "Shefi i sektorit ishte Nuredin Ibishi".

24 Pra, z. Ibishi nga këto dy pjesë duket se së pari Salih
25 Mustafa merrte urdhra prej Nuredin Ibishit. Ju sot na thatë se

1 ju nuk i jepnit urdhra Salih Mustafës. Atëherë, a po thoni ju
2 se Salih Mustafa ka gënjyer në deklaratën e tij?

3 Pë. Nuk them. Ajo është qëndrimi juaj, interpretimi juaj.

4 Nëse më pyesni për interpretimin tim, as nuk jap përgjigje.

5 Interpretimin duhet ta japë Z. Salih Mustafa. Mirëpo, ai

6 thotë, nëse e keni lexuar me vëmendje, thotë se i marrin nga

7 sektorët. Domethënë, qendra operative dhe sektorët. Duhet ta

8 interpretojë z. Mustafa. Se sektorët janë shërbimet, ato çka i

9 përmenda. Sektor shërbimi shëndetësor, sektor është

10 logjistika, sektorë janë personeli. Për këtë arsye unë nuk kam

11 qenë udhëheqës i sektorit.

12 Unë kam qenë shef i operatives. Për këtë arsye, ndoshta

13 është gabim në interpretim. Fakti është se...

14 Py. Z. Ibishi, nuk është, sepse këtu z. Mustafa saktësisht

15 flet për operativen. Pyetja është, cili në divizionin e

16 operatives, cili e kontaktonte nga operativja. Dhe ai thotë:

17 "Shefi i sektorit... Nuredin Ibishi".

18 Çfarë mund të thoni lidhur me këtë?

19 Pë. Asnjëherë s'kam qenë shef sektori.

20 Py. Ai nuk thotë pozitën, ai thotë emrin tuaj këtu. Salih

21 Mustafa po thotë, ai po ju përmend ju këtu.

22 Pë. Po, ai thotë sektorin. Sektorët janë shërbimet që unë i

23 përmenda. Unë, Nuredin Ibishi s'ka qenë udhëheqës i një

24 sektori. Ka qenë shef i operatives dhe ka qenë varësisht prej

25 kohës, a ka qenë komandant i brigadës, apo ka qenë shefi

1 shtabit. Pra, asnjëherë nuk kam qenë udhëheqës i sektorit.
2 Është e vërtetë që Salih Mustafa ka marrë urdhra prej
3 sektorëve, sektor të logjistikes, sektor të shëndetësisë,
4 sektor të personelit dhe sektorë të tjerë. Edhe këtu duhet të
5 dallohen.

6 Py. Z. Ibishi, në pjesën e parë që unë ju lexova - që është
7 pjesa 1, faqja 24 - është një pyetje shumë e qartë dhe pyetja
8 është për urdhrat. Pyetja i drejtohet z. Mustafa: "Kush jua
9 jepte urdhrat ty" dhe ai thotë Rustem Mustafa, ishte Kadri
10 Kastrati dhe Nuredin Ibishi.

11 Ju, a i keni dhënë urdhra z. Salih Mustafa, Z. Ibishi?
12 Pë. Unë thashë se, jo. Deklarova.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen e Trupit Gjykses,
14 dëshiroj t'i lexoj dëshmitarit një pjesë tjetër. Është një
15 deklaratë tjetër.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
17 vazhdoni.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]
19 Py. Flasim për të njëjtën temë. Do të doja t'ju tregoja z.
20 Ibishi, një deklaratë tjetër të Salih Mustafës, që kësaj here
21 e ka dhënë për çështjen Agron Zeqiri, çështje e UNMIK-ut.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do doja që të nxirrnim në ekran
23 të dhënat e seancës me dëshmitarin Salih Muastafa, numër
24 7000650 deri në 7000660, data 12 mars 2003. Do t'i kërkoja z.
25 Sekretar të Gjykatës, të shkojë në faqen 8 të këtij dokumenti.

1 Py. Është një pyetje në këtë faqe që i drejtohet z. Mustafës,
2 nga prokurori publik:

3 "A i raportoje drejtpërdrejt komandat Remit?

4 Salih Mustafa:

5 "Jo".

6 Prokurori publik:

7 "Kujt i raportoje"?

8 Salih Mustafa:

9 "Kryesisht raportimet ia përcillnim shefit të shtabit".

10 Pyetja e prokurorit publik:

11 "Nga cili i merrje urdhrat"?

12 Salih Mustafa:

13 "Nga shtabi i zonës. Ishte shefi i shtabit, ose me
14 telefon satelitor ose me radio".

15 Na thatë më herët sot, se ju ishit shefi i shtabit të
16 zonës operative të Llapit, apo nuk është kështu?

17 Pë. Po. Për një kohë të caktuar, po. Prej dhjetorit.

18 Py. Në këtë deklaratë Salih Mustafa thotë, në çështjen Agron
19 Zeqiri, se i raportonte shefit të shtabit. Konkretisht ju z.
20 Ibishi. Çfarë mund të thoni lidhur me këtë?

21 Pë. Më së pari, unë s'dua ta interpretoj deklaratën e
22 tjetërkujt. Nëse më pyesni mua, të lutem drejtomëni mua. Dhe
23 kjo është përgjigja.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Prokuror. Ai nuk e përmendi emrin në këtë moment. Në këtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 92

1 deklaratë nuk e thotë emrin e dëshmitarit. Ai thjeshtë thotë,
2 shefi i shtabit. Kjo është për procesverbal. Ta bëjmë të qartë
3 për procesverbal.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.
5 Prandaj po e pyes: A keni qenë shef i shtabit të zonës
6 operative të Llapit? Dhe përgjigja e dëshmitarit është: Po,
7 isha për njëfarë periudhe kohore. Por emri vërtetë nuk thuhet
8 këtu.

9 Py. Pra, z. Mustafa tha ato që sapo lexova. Atëherë, ju
10 sugjeroni se z. Mustafa gënjen kur thotë që i ka raportuar
11 shefit të shtabit të Zonës Operative të Llapit?
12 Pë. Ndoshta duhet të përmbaheni prej këtyre fyerjeve. Edhe
13 njëherë po ju them, deklaratat secili i interpreton të vetat.
14 Mos mu drejtoni mua me fjalë fyese ndaj Salih Mustafës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar. Ju lutem, mos e akuzoni z. Prokuror që po ofendon.
17 Askush nuk po ju ofendon. Po ju bëjmë pyetje, po ju drejtojmë
18 pyetje. Ju lutem kontrolloni tonin e zërit dhe kontrolloni
19 gjuhën.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]
21 Py. Z. Ibishi, thjesht po përpiqem të kuptoj. Sepse ju na
22 thatë sot dhe na e thatë disa herë, se nuk i keni lëshuar
23 asnjë urdhër Salih Mustafës apo njësitit BIA që drejtonte ai.
24 Ju kam treguar disa pjesë të ndryshme të deklaratës së Salih
25 Mustafës, së dëshmisë së tij, ku me sa duket ai thotë diçka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 93

1 ndryshe. Ku, në fakt sipas tij, i jepnit urdhra. Unë po
2 përpiqem të kuptoj cila është e vërteta, prandaj po jua bëj
3 këto pyetje. Ose ai po gënjen në deklaratën e tij, ose ju nuk
4 po na tregoni çdo gjë këtu. Prandaj po ju pyes. Mund të na
5 thoni këtu, ju lutem, a i jepni urdhra Salih Mustafës apo jo?
6 Pë. Unë ju thashë, nuk kam nevojë 100 herë t'jua përsëris.
7 Jo, s'kam dhënë. Dhe tjetra është se, nuk dua të interpretoj
8 deklaratën e tjetërkujt. Nëse doni ju, e kërkoni interpretimin
9 konkret pas dëgjimit tim.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Do të doja
11 t'i bëja disa pyetje të tjera lidhur me dhënien dhe marrjen e
12 urdhrave. Me lejen tuaj dëshiroj t'i tregoj një deklaratë
13 tjetër këtij dëshmitari, të një dëshmitari në fakt tjetër që
14 ka dhënë dëshmi para këtij Trupi Gjykues.

15 Z. Sekretar i Gjykatës, nuk e di nëse është e mundur
16 teknikisht, por doja t'i tregoja dëshmitarit një pjesë shumë
17 të shkurtër të dëshmisë që ka dhënë në gjyq Fatmir Humolli.
18 Dhe flasim për deklaratën e datës 2 shkurt 2022. Konkretisht
19 është faqja 2417, rreshtat 4 deri në 25. Nëse nuk është e
20 mundur nga ana teknike, unë mund ta lexoj ngadalë këtë pjesë.
21 Çfarëdo që të jetë më e volitshme. Faqja 2417.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit z. Sekretar i Gjykatës.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

25 Py. Z. Ibishi, dëgjoni me kujdes shkurtimisht një shkëmbim të

1 shkurtër mes Prokurorit të Specializuar dhe Fatmir Homollit në
2 këtë gjykim, para disa javësh. Në këtë sallë gjyqi. Pyetja,
3 rreshti 4:

4 "Kujt i raportonte BIA në Zonën Operative të Llapit".

5 Përgjigja:

6 "Pë. Komandantit të Zonës Operative të Llapit dhe shefit
7 të Zonës Operative të Llapit".

8 "Py. Cili ishte shefi i Zonës Operative të Llapit. A mund
9 të na e kujtoni"?

10 "Pë. Nuredin Ibishi ishte komandant i Zonës Operative".

11 "Py. Cila ishte pozita e tij ekzakte në Zonën Operative
12 të Llapit. A mund të na e tregosh"?

13 "Pë. Për kë po flet"?

14 "Py. Po flas për Nuredin Ibishin".

15 "Pë. Ishte shefi i operatives".

16 "Py. Z. Humolli, njësitit BIA a merrte urdhra nga Rrustem
17 Mustafa, Nuredin Ibishi, apo nga të dy prej tyre"?

18 "Pë. Njësitit BIA ishte nën komandën e Salih Mustafës.

19 Ndërsa Salih Mustafa i merrte urdhrat nga shefi i shtabit ose
20 komanda e zonës operative".

21 "Py. Pra, ose nga Rrustem Mustafa ose nga Nuredin Ibishi.
22 A është kështu"?

23 "Pë. Po. Struktura operative kalonte përmes Nuredin
24 Ibishit. Por meqë guerilja ishte më e ndjeshme, atëherë
25 komandanti i Zonës Operative të Llapit kishte po ashtu

1 autoritet.”

2 Pra, Z. Ibishi, edhe Fatmir Humolli që ka qenë pjesë e
3 Zonës Operative të Llapit në pjesën e komandës, po thotë këtu
4 që Salih Mustafa dhe njësitit BIA merrnin urdhra edhe prej
5 jush. A është e saktë kjo që ka thënë?

6 Pë. Unë e thashë që nuk kam dhënë urdhër. A kam mund me
7 dhënë, është çështje tjetër. Mirëpo, unë nuk kam dhënë. Këtu
8 është përgjigja strikte. S’di a e kam të qartë.

9 Py. Po. Thjesht për të qenë të qartë. Ju nuk i keni dhënë
10 urdhra as Salih Mustafës dhe askujt prej pjesëtarëve të
11 njësitit BIA gjatë luftës. Këtë po thoni?

12 Pë. Po.

13 Py. Z. Ibishi, a mund të jepnit urdhra ju nëse dëshironit?
14 Urdhra BIA-s apo Salih Mustafës?

15 Pë. Me siguri, po. Se ajo, kur ka qenë në kuadër të
16 strukturës, ka mund me i dhënë edhe komandanti i zonës, edhe
17 zëvendëskomandanti edhe unë edhe normal po të kishte pas
18 nevojë me i dhënë. Mirëpo në raport me mua, s’kam dhënë
19 urdhra. Aty është problemi, jo problemi po aty është çështja.

20 Py. Pra, ajo që ka thënë Fatmir Humolli nuk është e saktë?

21 Pë. Duhet ta pyesni atë.

22 Py. Po ju pyes ju tani. Ai e ka thënë diçka që është në
23 kundërshtim me dëshminë tuaj sot. Gjykata duhet të dijë cila
24 është e vërteta.

25 Pë. Duhet ta ftoni atë dhe të kërkonit interpretim të saktë

1 çka ka menduar.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Dëshmitar, përgjigjuni pyetjes. A është e vërtetë ajo çka ka

4 thënë z. Fatmir Humolli? Nuk është e ndërlikuar. E dimë që po

5 i vjen rreth e rrotull pyetjes dhe ne jemi ulur këtu dhe po ju

6 dëgjojmë. Por ai po thotë diçka ndryshe nga çka po thoni ju

7 dhe do doja të merrja një përgjigje prej jush.

8 DËSHMITARI: E nderuar znj. Kryetare, i nderuari

9 Prokuror, për këtë çështje, unë nuk dua asnjë deklaratë të

10 kurrkujt t'ia interpretoj. Edhe për atë arsye nuk dua ta

11 komentoje fare këtë. Dhe kjo është përgjigja ime.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull mund të vazhdojmë.

13 Mund ta ndryshojmë pak temën të nderuar Gjykatës.

14 Py. Sot...

15 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

17 Prokuror, do ta marr unë fjalën tani për tani.

18 Z. Ibishi, ju duhet të na jepni një përgjigje. Ju nuk

19 mund të zgjidhni e të thoni, "Ftoni dëshmitarin tjetër

20 përsëri". Ai këtu ka thënë:

21 "Njësitë BIA ishte nën komandën e Salih Mustafës. Ndërsa

22 Salih Mustafa merrte urdhra nga shefi i shtabit ose komanda e

23 zonës operative".

24 Pyetja është:

25 "Pra, ose nga Rrustem Mustafa ose Nuredin Ibishi, a është

1 kështu”?

2 Dhe përgjigja e Fatmir Humollit është:

3 “Po, struktura operative kalonte përmes Nuredin
4 Ibishit”.

5 Dhe unë dua të di prej jush nëse kjo është e saktë apo
6 jo. Dhe ju lutem mos u përgjigj në këtë formë që “Duhet të
7 pyesim atë”. A është kështu?

8 DËSHMITARI: Unë prapë -- po më vjen keq që duhet të
9 them. Unë e thashë, s’kam dhënë urdhra. Dhe shef i operatives
10 kam qenë së bashku me Kadri Kastratin. Unë dhe Kadri Kastrati,
11 zv. Komandanti, kemi udhëheq operativen. S’kam qenë veç unë.
12 Të kuptohemi, ndoshta ta kemi të qartë. Edhe unë për sa i
13 përket vetes sime, unë s’kam dhënë urdhra. Dhe kjo është
14 përgjigja ime, e nderuar znj. Kryetare.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
16 përshtypjen se këtu është thënë diçka krejt ndryshe. A po na
17 thoni ju që kjo nuk është e vërtetë, çka na ka thënë z. Fatmir
18 Humolli? Kjo është pyetja. Nuk po hyjmë në detaje, a është e
19 vërtetë apo jo?

20 DËSHMITARI: Unë nuk e mohoj që së bashku me Kadri
21 Kastratin kemi qenë shefat e operatives, të dy e kemi
22 udhëheqë. Përveç pozicionit unë si shef shtabi, ai si zv.
23 komandant, ne bashkërisht kemi udhëhequr. Mirëpo, personalisht
24 unë nuk kam dhënë urdhra BIA-s edhe kjo është përgjigja ime.
25 Nuk e di a mjafton.

1 Se nesër vjen çështja, pse unë ta lëndoju këtë apo atë.
2 Nëse ai ka diçka për interpretim, ai ndoshta thotë nesër, "unë
3 e kam menduar ndryshe mundësitë që ti me i dhënë urdhra", dhe
4 jo "i ke dhënë urdhra". Unë konkretisht po përgjigjem, që nuk
5 i kam dhënë urdhra si njëri prej udhëheqësve të operativës. Se
6 përveç meje edhe Kadri Kastrati ka qenë pjesë e operativës
7 sikurse dhe unë. Të dy e kemi udhëheq bashkërisht. Ndërsa
8 pozita primare ka qenë...

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
10 kam ndërprerë, kështu që nuk po ju përkthejnë. Nëse them unë
11 ndaloni, ju lutem ndaloni.

12 Z. Fatmir Humolli thotë, pyetja është:

13 "Ose nga Rrustem Mustafa, ose nga Nuredin Ibishi".

14 Po flasim për urdhrat.

15 "A është kështu"?

16 Dhe ai thotë:

17 "Po".

18 Pra, ai fjalë për fjalë përmend emrin tuaj, shprehimisht
19 emrin tuaj. Dhe unë dua të marr vesh prej jush nëse është e
20 vërtetë, nëse kjo që po thotë ai këtu, nuk është e vërtetë.
21 Këtë dua të më thoni.

22 DËSHMITARI: Pse po kërkonit prej meje, a është e vërtetë a
23 s'është e vërtetë. Unë po ju them, pozita ime një kohë të
24 caktuar ka qenë, njëherë komandant i Brigadës 151, edhe mandej
25 shef i shtabit. Por, së bashku me Kadri Kastratin,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 99

1 zëvendëskomandantin e zonës, kemi udhëhequr operativen.

2 Edhe nëse më pyetni a kam dhënë urdhra ndaj BIA-s, unë po
3 kufizohem se, s'kam dhënë. Unë nuk mund ta interpretoj
4 deklaratën e dikujt tjetër. Këto janë -- kjo përgjigja ime. Se
5 nesër ai më thotë Fatmir Humolli apo Cali apo dikush, thotë
6 "Unë e kam menduar ndryshe, pse ti më thua nuk është e saktë
7 apo është rrenë apo diçka sikur". Për këtë arsye ju kisha
8 lutur të më kurseni prej kësaj qasje. Unë isha shumë...

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
10 në këtë moment nuk po ju kursej asgjë lidhur me këtë. Sepse
11 jeni i detyruar t'i përgjigjeni pyetjes. Nuk ju kursej nga
12 kjo. Jeni i detyruar t'i përgjigjeni pyetjes që ju është
13 ngritur. Është e thjeshtë, dua të dëgjoj prej jush nëse është
14 e saktë apo jo që BIA merrte urdhra nga Nuredin Ibishi sikurse
15 ka thënë Fatmir Humolli. Unë dua ta dëgjoj prej jush nëse ju
16 mendoni se deklarata e tij është e saktë apo jo, lidhur me
17 këtë.

18 DËSHMITARI: Unë nuk kam dhënë urdhra. Dhe kjo është
19 përgjigja ime.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Atëherë unë po ju them që unë po e marr si përgjigje këtë për
22 momentin. Pra, ju po thoni dhe kjo është përmbledhja ime, ju
23 po thoni që, ajo që i ka thënë z. Humolli kësaj Gjykate nuk
24 është e vërtetë. Kështu e përmbledh unë atë që sapo e thatë
25 ju. Pajtoheni me këtë?

1 DËSHMITARI: Ju po e thoni.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
3 na u desh shumë kohë, mund të na e kishit thënë qysh në
4 fillim, ajo që tha ai s'është e vërtetë. Në të vërtetë, po. Na
5 u desh shumë kohë për të marrë këtë përgjigje prej jush dhe
6 nuk ishte e nevojshme. Nuk qe e nevojshme kjo.

7 Z. Prokuror, vazhdoni.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
9 Gjykatës.

10 Py. Z. Ibishi, do të ndryshojmë pak temën, nëse mundem. Sot,
11 në faqen 19, rreshti 12-12, thatë se BIA ishte një strukturë
12 civile dhe se pjesëtarët e BIA-s ishin të paarmatosur. A është
13 kështu, e saktë?

14 Pë. Po, ashtu ka qenë në princip.

15 Py. Pjesëtarët e BIA-s gjatë luftës, a vishnin uniforma, a
16 mbanin uniforma?

17 Pë. Jo. Gjatë misionit që kanë pas si njësitë BIA, jo. Përveç
18 në rastin kur u urdhërua, mirëpo edhe për këtë nuk jam i
19 sigurt, kur u urdhërua mobilizimi i përgjithshëm nga data 27
20 prill i vitit 1999, nga qeveria e përkohshme e Kosovës për
21 mobilizim të përgjithshëm. Atëherë situata ka ndryshuar pasi
22 që të gjitha strukturat, edhe mbrojtja civile, u aktivizuan --
23 mbrojtja civile kaloi në pjesën aktive. Por, sa unë e di, edhe
24 BIA në bazë të asaj që kam njohuri, megjithëse këtë e kam të
25 pasigurt, se a ka ndodhur edhe me BIA-s çështja e mobilizimit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 101

1 në njësitë mbrojtëse. S'jam i sigurt për këtë deklaratë, por e
2 di që më 27 prill të vitit 1999, është dhënë urdhri për
3 mobilizim të tërësishëm të njësiteve që kanë qenë mbrojtja
4 civile, tash për BIA-n nuk jam shumë i sigurt. Po supozoj se
5 edhe ajo ka qenë e njëjtë.

6 Py. Pra, për ta përmbledhur atë që thatë ju: deri më 27 prill
7 të 1999, pjesëtarët e BIA-s nuk mbanin uniforma. Mbase pas
8 datës 27, mbase po mbanin uniforma në kuadër të mobilizimit të
9 përgjithshëm të njësiteve të UÇK-se, a po thoni këtë?

10 Z. VON BONE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 qoftë se e keni fjalën për përmbajtjen e pyetje, atëherë na
13 duhet t'i kërkojmë dëshmitarit të dalë nga salla e Gjyqit.

14 Flisni në mikrofon se nuk ju dëgjoj.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
17 Asistente e Gjykatës, ju lutem që ta shoqëroni dëshmitarin që
18 të dalë jashtë sallës së gjyqit.

19 Z. Dëshmitar, tani do t'ju kërkojmë të dilni nga salla.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, Asistente e Gjykatës.

23 Avokat i Mbrojtjes, ju e keni fjalën.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

25 Gjykatëse. Pyetja nëse anëtarët e BIA-s kishin uniforma apo

1 jo, është një pyetje shumë e përgjithshme. Pasi fillimisht ne
2 nuk e dimë se kush është anëtar i BIA-s dhe kush nuk është. Të
3 paktën dëshmitari e ka thënë një gjë të tillë. Dhe prandaj
4 është pothuajse e pamundur që të bëhet një përgjithësim i
5 kësaj natyre, lidhur me se nga çfarë përbëhej uniforma. Në
6 qoftë se një person ka një xhaketë të gjelbër, për shembull,
7 do të ishte kjo uniformë apo jo. Në qoftë se ndoshta atë
8 civilët e kanë veshur gjatë luftës.

9 Pra, është më mirë që pyetja të jetë më specifike me
10 qëllim që të kuptonim pikërisht se për çfarë bëhet fjalë,
11 bëhet fjalë për një kohë të caktuar të veshjes për anëtarët e
12 BIA-s e kështu me radhë. Cili është informacioni që ka pasur
13 ai, cilat ishin arsyet për një përgjigje që mund të jetë "po"
14 apo "jo". Në qoftë se një përgjigje e tillë do të jepet e
15 kështu me radhë.

16 Për shkak se aktualisht pyetja është e natyrës shumë të
17 përgjithshme.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Ndoshta nuk më kujtohet më parë, por më duket sikur edhe ju në
20 të shkuarën keni pyetur nëse njerëzit kishin veshur uniforma.
21 Dhe nuk ka qenë asnjëherë problem kjo çështje.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë mendoj që këtu është një
23 problem dhe prandaj unë po kundërshtoj përgjithësimin,
24 pavarësisht se çfarë është thënë në të shkuarën apo jo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

1 Por ju e keni bërë një pyetje të tillë vetë në të shkuarën dhe
2 nuk ishte e saktë në atë kohë. Dhe mos më ndërhyjni kur jam
3 duke folur. Por do t'ia jap fjalën tani Prokurorit për të
4 dëgjuar se çfarë ka për të thënë ai.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Më lejoni të shtoj se ndoshta kjo
6 i është bërë një personi i cili ishte anëtar i BIA-s. Ndërsa
7 ky person aktualisht, nuk është anëtar i BIA-s dhe nuk mund të
8 thotë ndonjë gjë. Ai thotë që është thjeshtë një njësiti civil.
9 Dhe prandaj kërkova që pyetja të jetë më specifike.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
11 ka nevojë që ta përsërisni veten tuaj. Ju kam dëgjuar herën e
12 parë.

13 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse. Unë e
15 kisha shumë të thjeshtë pyetjen time. Z. Ibishi kur e pyeti
16 Mbrojtja tha që BIA nuk ishte një formacion ushtarak. Dhe ka
17 disa tregues të ushtarëve të cilët marrin pjesë në veprime
18 ushtarake dhe një nga këto të dhëna është që kanë uniformë.
19 Dhe prandaj e bëra këtë pyetje.

20 Ai tha që ishin të paarmatosur dhe ky dëshmitar mund të
21 na thotë nëse ka pasur uniforma apo jo. Ai mund të na japë
22 shembuj nëse anëtarët e BIA-s, për shembull Salih Mustafa si
23 komandant i këtij njësiti, kishin veshur uniforma apo jo. Unë
24 mund ta kufizoj dhe të pyesja thjesht vetëm për Salih
25 Mustafën.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Më falni.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
3 që po buzëqeshni dhe më duket se po thoni, po.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, jo. Dëshmitari ka thënë që
5 nuk e ka njohur Salih Mustafën gjatë luftës. Në qoftë se bëhet
6 kjo pyetje, atëherë duhet të jetë e parashtruar fillimisht që
7 bëhet fjalë për periudhën gjatë luftës.

8 Ne e kemi pasur këtë më parë, ne nuk e dimë që kur ka
9 përfunduar lufta. E dimë që, shumë pranohet, kur ka hyrë KFOR-
10 i në qershor. Por, ky person ka thënë që nuk e ka njohur gjatë
11 luftës Salih Mustafën. Ndoshta mund ta ketë parë, por nuk e ka
12 njohur personalisht. Kështu që në këtë kontekst nuk do të
13 ishte e drejtë që të pyetej nëse ky person Salih Mustafa ka
14 veshur uniformë apo jo në atë periudhë.

15 Për cilën periudhë kohore bëhet fjalë, bëhet fjalë për
16 kohën para luftës, në kapacitetin si anëtar i BIA-s, apo jo?

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] T'i përgjigjem.

18 Të nderuar Gjykatës. Ky dëshmitar ka thënë se anëtarët e
19 BIA-s nuk kanë veshur uniformë dhe ai tha që kjo nënkupton se
20 si ka qenë në kontakt me ta. Pasi e tha që nuk kanë pasur
21 uniforma. Dhe në qoftë se ai ka pasur kontakte me ta, ai është
22 në gjendje që ta konfirmojë nëse një gjë e tillë është e
23 vërtetë apo jo.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
25 vazhdoni. Jam përpjekur që të kuptoj se nga çfarë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 105

1 këndvështrimi e shihni ju këtë, Avokat i Mbrojtjes, por unë
2 mendoj që nuk është problem fare që të bëhet një pyetje e
3 tillë.

4 Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem ta sjellim përsëri
5 këtu dëshmitarin.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 se vini edhe njëherë z. Dëshmitar. Dhe ju falënderoj që ju
9 duhet të hyni dhe të dilni.

10 Prokuror, ju e keni fjalën përsëri.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

12 Py. Z. Ibishi, unë ju pyeta nëse anëtarët e BIA-s kanë veshur
13 uniforma apo jo. Dhe ju thatë diçka që nënkuptonte që para 27
14 prillit 1999, anëtarët e BIA-s nuk kanë pasur uniformë. A
15 është e saktë kjo?

16 Pë. Po. Ata kanë qenë civil, kanë vepruar civil. Çfarë
17 logjike ka të jenë në zona urbane ku janë policia dhe armata
18 apo forcat e armatosura të Serbisë, pra ata kanë qenë civil.
19 Ndërsa-- Unë po flas për mbas 27, pra ajo gjendja ndoshta ka
20 ndryshuar për shkak se është dhënë mobilizimi i tërësishëm i
21 të gjitha strukturave në forca mbrojtëse, për shkak të vetë
22 situatës së krijuar.

23 Py. Ju kuptoj, z. Ibishi. Faleminderit për përgjigjen tuaj.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar
25 Gjykatës, dua t'i paraqesim dëshmitarit dy fotografi. Dhe nëse

1 më lejoni, do t'i kërkoja Sekretarisë që t'i vendoste në
2 ekran.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Vazhdoni, po.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Sekretar, do t'ju kërkoja që
6 të vendosim dokumentin ERN SPOE00222617 deri në 00222617.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Prokuror, po ju them që po i afrohem orës 14.45 që është
9 momenti kur duam të marrim pushimin.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, po i
11 tregoj këtë fotografi dëshmitarit dhe ndoshta dhe fotografinë
12 pasuese edhe ndoshta do ta përfundoj këtu.

13 Py. Z. Ibishi, a njihni ndonjë nga personat që tregohen në
14 këtë fotografi?

15 Pë. Po. Po e njoh Calin. Edhe s'po di, s'jam i sigurt për
16 këtë tjetrin.

17 Py. Kush është Cali në këtë fotografi? Në çfarë pjese të
18 fotografisë është, në këmbë apo i ulur?

19 Pë. Në këmbë, po. Në anë të djathtë, në krahasim me shikimin
20 tim, po.

21 Py. Ka beretë apo ka kapele?

22 Pë. Beretë.

23 Py. Tre personat që janë në këtë fotografi, përfshirë Salih
24 Mustafën shefi i BIA-s, që të tre kanë veshur uniforma. A
25 është kështu?

1 Pë. Po, në uniforma janë.

2 Py. A kanë edhe emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në
3 uniformë si dhe në kapele?

4 Pë. Po.

5 Py. A janë të armatosur që të tre?

6 Pë. Po.

7 Py. Njeri prej tyre duket sikur ka një granatahedhës. A është
8 kështu?

9 Pë. Po. Mortaje.

10 Py. Z. Ibishi, duken si civilë këto në sytë e tu?

11 Pë. Jo.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nëse më lejoni, të nderuar
13 Gjykatës, dua t'i tregoj dëshmitarit një fotografi tjetër.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Vazhdoni.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] ERN SPOE00222690 deri në
17 00222690.

18 Py. Z. Ibishi, hidhi një sy edhe kësaj fotografie. A njihni
19 ndonjë nga personat që tregohen në këtë fotografi?

20 Pë. Po. Thashë se po i njoh. Po. Për Calin, për Salih
21 Mustafën.

22 Py. Pra, të katërt këta persona kanë veshur uniformë dhe kanë
23 emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. A është e saktë?

24 Pë. E saktë është. Por është pyetje edhe koha edhe çështja e
25 asaj se, nëse kanë dalë në fotografi me uniformë, nuk është e

1 thënë se ata kanë mbajtur atë uniformë. Kanë mundur të veshin
2 uniformë për t'u fotografuar. Kjo, s'po di sa është kjo, shpesh
3 më ka ndodhë ma ka kërkuar dikush uniformën vetëm sa për
4 fotografi. Tash po mendoj është një -- s'po du as ta hedh --
5 s'po di koha, cilës kohë i referohet kjo fotografi edhe a
6 është uniforma e tij, apo vetëm ka dasht ta veshi sa për me ba
7 një foto. Këto dy çështje të pa qartësuara.

8 Py. Këto persona në fotografi, a janë të armatosur?

9 Pë. Po.

10 Py. Dhe ju keni konfirmuar që Salih Mustafa ka qenë komandant
11 i BIA-s gjatë luftës.

12 Pë. Po.

13 Py. Pra, Z. Salih Mustafa ishte kryetari i një organizate
14 civile të paarmatosur dhe pa uniforma.

15 Pë. Unë prapë, pyetja ime është fotografia nuk është
16 domethënëse se, ai ka mbart uniformën nëse është fotografuar
17 një herë a dy herë a sa, a kupton. Mirëpo s'po du tash të
18 interpretoj këtë, unë vetëm po e konfirmoj këtë dhe nuk po di
19 edhe kohën, në cilën kohë e referohen këto dy fotografi. Pasi
20 që po më drejtoheni mua.

21 Py. Z. Ibishi, ta lëmë vlerësimin tuaj të këtyre fotografive.
22 Ta lëmë që ta bëjë Paneli këtë vlerësim.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Sekretar, mund ta heqim nga
24 ekranin.

25 Të nderuar Gjykatës, mund ta pezullojmë këtu të marrim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 109

1 pushimin.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit z. Prokuror.

4 Z. Ibishi, do të marrim një pushim prej gjysmë ore deri
5 në orën 15.15 dhe do t'i kërkoj Asistentes së Gjykatës që t'ju
6 shoqërojë nga salla e Gjyqit. Shihemi më pas. Faleminderit.

7 DËSHMITARI: Faleminderit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit znj. Asistente e Gjykatës.

11 Marrin një pushim gjysmë orë, deri në orën 15.15. Dhe
12 vazhdojmë më pas.

13 Z. Prokuror, sa kohë mendoni se do t'ju duhet për pjesën
14 e dytë të pyetjeve tuaja?

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në varësi të gjatësisë së
16 përgjigjes së këtij dëshmitari, do të thosha rreth 30 minuta,
17 40. Por çdo gjë do të varet nga mënyra se si do t'i përgjigjet
18 pyetjeve të mia dëshmitari.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit z. Prokuror.

21 Mbyllet seanca këtu.

22 --- Pauza fillon në orën 14.44

23 --- Seanca rifillon në orën 15.15

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
25 se vini. Vërej që jemi të njëjtë që ishim edhe më parë dhe

1 mund të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit. Kam një pyetje
2 për palën Mbrojtëse, sidoqoftë, për sa i përket datës së
3 deklaratës pa betim të z. Mustafa.

4 Ju thatë që preferoni që kjo të bëhej më datën 19, ditë e
5 enjte. Dhe unë dëshiroj që të kemi një ditë rezervë. Kështu që
6 kur ju dhashë tre ditë, unë po mendoj dy, në fakt. Kështu që
7 do të kisha preferuar që ta fillonim të mërkurën, kështu që
8 dita shtesë gjatë asaj jave është për çdo gjë të
9 parashikueshme që mund të ndodhë, pra, prandaj dhe kjo është
10 arsyeja, pra. A ka ndonjë arsye specifike që mund të mos e
11 fillojmë në datën 18, ditën e mërkurë?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Ekziston një arsye specifike të
13 cilën nuk dua që ta them në publik. A mund ta bëj me email?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
15 Në atë rast, pra, duke patur parasysh dëshirën time që të kem
16 një ditë rezervë, ndoshta mund ta bëjmë ditën e martë edhe të
17 enjte?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Situata ndërlikohet shumë më
19 tepër në qoftë se përmendim të martën.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Dakord. Më dërgo një email që ta kuptoj se për çfarë bëhet
22 fjalë. Tani për tani e mbarojmë këtë diskutim. Dakord.

23 Atëherë ka ardhur momenti për ta sjellë përsëri
24 dëshmitarin në sallë. Faleminderit, Asistentja e Gjykatës.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
2 se vini edhe njëherë, z. Ibishi. Si jeni?

3 DËSHMITARI: Mirë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Dakord. Do të vazhdojmë me kundërpyetjet e Zyrës së Prokurorit
6 të Specializuar dhe fjalën e ka Prokurori.

7 Ju e keni fjalën.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
9 Gjykatës.

10 Py. Z. Ibishi, mirë se vini dhe njëherë.

11 Pë. Faleminderit.

12 Py. Disa herë gjatë ditës së sotme ju na thatë që BIA ishte,
13 pak a shumë, një strukturë civile; apo jo?

14 Pë. Po.

15 Py. A ka marrë pjesë në operacione luftarake gjatë kohës së
16 luftës BIA?

17 Pë. Unë do vetëm këtu ta kjartësoj. Nëse flasim pas 27
18 prillit 1999, kur është bë mobilizimi i tërësishëm. Këtu e kam
19 ende të pakjartë edhe jam i pasigurtë nëse është pas -- nga
20 kjo datë e tutje, është në rregull. Përpara nuk kam marrë
21 pjesë, në sa e di unë.

22 Py. Z. Ibishi, a ju kujtohet ofensiva serbe e prillit në
23 rajonin e Gollakut?

24 Pë. Nuk po di për cilën ofensivë e keni fjalën. Më detaje.

25 Py. Në këtë gjyq kemi dëgjuar që të jetë zhvilluar një

1 operacion serb, gjatë të cilit janë sulmuar një numër
2 fshatrash në rajonin e Gollakut. A dini gjë për këtë
3 operacion?

4 Pë. Edhe në cilës kohë i referoheni pasi që ka pasë shumë
5 sulme në rajonin e Gollakut?

6 Py. Për çështjen tonë, për ju më relevante është ajo e
7 prillit. A keni dijeni lidhur me një operacion serb të nisur
8 nga forcat serbe në zonën e Gollakut në prill të vitit 1999?

9 Pë. Po.

10 Py. A keni dijeni nëse në luftim të asaj kohe kanë marrë
11 pjesë njësitë e BIA-s?

12 Pë. Jo, nuk kam dijeni, por e di për krimet makabre që kanë
13 ndodhë nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe nga
14 Koliqi e deri në Llukarë, domethënë.

15 Py. Z. Ibishi, pyetja ime ishte nëse kanë marrë pjesë në
16 luftime edhe anëtarë, në luftimin kundër forcave serbe edhe
17 forcat e BIA-s si pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

18 Pë. Po edhe një herë në mënyrë specifike, a po thoni për
19 cilën datë saktësisht?

20 Py. Unë nuk do t'ju jap juve përgjigjet Z. Ibishi. Unë po ju
21 pyes nëse keni patur dijeni mbi operacionet serbe në Gollak
22 dhe pyetja ime është shumë e thjeshtë: A kanë marrë pjesë
23 njësitet e BIA-s në operacionet luftarake në Gollak gjatë
24 këtij operacioni? Kjo është pyetja ime.

25 Pë. Ka pasë shumë operacione edhe në prill, po unë tash nuk

1 po di cillit operacion serb po i referoheni saktësisht. Një
2 kohë ka ndodhë këto masakrat e mëdha në këtë pjesë të terrenit
3 çfarë e përshkruajta ma herët, pra, nga prej Koliqit e deri në
4 Sharban. Mirë Sharban, po në -- më fal, Koliq, Marevc po,
5 Grashticë, Makovc dhe Llukar deri në hymje, domethënë, të
6 Prishtinës. Këto janë datat dikun 18, 19, 21, ashtu diçka i
7 referohem në prill. Nëse është për këtë ofensivë serbe, pra,
8 kur janë krye masakrat, është një.

9 Por ka pasë edhe operacione serbe të vazhdueshme në këtë
10 pjesë. Po flasim për pjesën më të ngarkuar, të them, të
11 operacioneve serbe që llogaritet si i pastrimit etnik,
12 domethënë, siç quhet operacioni famëkeq "Patkoi". E për këtë
13 arsye nuk po dihet saktësisht apo folim -- se data është me
14 rëndësi. Unë e përmenda jo rastësisht 27 prillin kur Qeveria e
15 Përkohshme ka dhënë urdhrin për mobilizimin e tërësishëm, çka
16 po nënkupton që të gjithë janë armatos edhe i kundërvu me të
17 gjitha mjetet, domethënë, kësaj ofensive të madhe serbe të
18 pastrimit etnik të territorit. E tash për këtë arsye është
19 shumë relevante me ditë a po folni për 27 prillit e mbrapa apo
20 folni pej 26 e përpara.

21 Py. Përpara 27 prillit 1999, a ka marrë pjesë BIA në ndonjë
22 operacion luftarak? Kjo është pyetja ime.

23 Pë. Unë nuk njohuri për këtë.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse më
25 lejoni do të dua që t'i tregojmë dëshmitarit një dëshmi. Është

1 dëshmia që ka dhënë Fatmir Sopi para këtij Trupi Gjykses. Nëse
2 më lejoni, do t'i kërkoja Sekretarisë që ta bëjë këtë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Vazhdoni.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do t'i kërkoja Sekretarisë që
6 të vendosë transkriptin e dëshmisë së z. Fatmir Sopi të dhënë
7 më datën 18 janar 2022, faqen 2064, rreshtat 2 deri në 9. Edhe
8 njëherë e përsëris, është faqja 2064, rreshti 2 deri në 9.
9 Py. Z. Ibishi, në dëshminë e tij, në këtë sallë gjyqi, Fatmir
10 Sopi ka përmendur që BIA ka marrë pjesë në operacione
11 luftarake, ta shikojmë. Pyetja:

12 "A ju kujtohet që i keni thënë Gjykatësit Hetues dhe
13 është e vërtetë ajo që keni ditur me atë njësit?

14 Përgjigje:

15 "Po, ja thashë këtë Gjykatësit Hetues dhe po e përsëris,
16 që këto detyra janë ushtruar edhe nga njësitet guerilase të
17 BIA-s. Dhe ajo ka shërbyer si furnizues jo vetëm për zonën
18 operative të Llapit por edhe për njësite të tjera të UÇK-së në
19 Kosovë. Dhe kur ishte e domosdoshme, ata kanë marrë pjesë në
20 luftime, në betejat e ndërmarra nga njësitet e tjera të UÇK-së
21 të Brigadës 153 apo çfarëdolloj njësiti tjetër i cili ka marrë
22 pjesë në beteja".

23 Pra, Z. Ibishi, Fatmir Sopi përmend këtu një numër
24 betejash në të cilat të ketë marrë pjesë BIA. Çfarë do të
25 thoni? Çfarë keni për të thënë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 115

1 Pë. Po ai përmend që ka qenë mbështetëse, *supplier*. Mirëpo,
2 unë nuk kam këtë njohur që BIA ka marrë pjesë në operacione
3 luftarake në kohën para 27 prillit.

4 Py. Dakord.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse më
6 lejoni do t'ju kërkoja juve që t'i paraqesim dëshmitarit një
7 pjesë të dëshmisë së të akuzuarit të kësaj çështje, pra,
8 deklaratës së z. Salih Mustafa. Është deklarata 19 nëntorit
9 2019, 069404-TR-ET, Pjesa 4, në faqen 2. Pra, Pjesa 4, në
10 faqen 2 dhe fillon tek rreshti 21.

11 Py. Dëgjoni Z. Ibishi, se çka thënë z. Salih Mustafa vetë për
12 sa i përket marrjes pjesë në operacione luftarake. Salih
13 Mustafa ka thënë si më poshtë:

14 "Megjithëkëtë, kur ata qëndronin për një -- kur qëndronin
15 për një ditë, dy, apo tre, apo kur ne kemi ndihmuar në luftime
16 njerëzit të cilët merrnin pjesë në luftime, njësitet të cilët
17 kanë marrë pjesë në luftime, pavarësisht nëse ishin 10, 20 apo
18 30 persona, atëherë këto ato do të visheshin me uniformë por
19 bereja nuk ishte pjesë e uniformës së secilit ushtar".

20 Këtu z. Ibishi, Salih Mustafa flet për pjesëmarrjen në
21 luftime të njësiteve të BIA-s me ç'rast ato vishnin uniforma.
22 A vazhdoni t'i përmbaheni mendimit tuaj z. Ibishi se ushtarët
23 e BIA-s nuk kanë marrë pjesë në operacione luftarake?

24 Pë. Ku përmendet këtu BIA? Unë s'po e shoh që përmendet BIA.

25 Py. Po të shohim lart, në këtë faqe bëhet fjalë për

1 pjesëmarrjen edhe po ta ngremë faqen pak më lartë, bëhet fjalë
2 për pjesëmarrjen e njësiteve të tij. Shikoni, për shembull,
3 rreshtin 9. Përgjigja që ka të bëjë me ushtarët guerilas të
4 BIA-s, të cilët në përgjithësi nuk mbanin uniforma, por ata i
5 vishnin uniformat në rastet kur merrnin pjesë në luftime, në
6 operacione luftarake. Mund të filloni që në rreshtin 4 po të
7 dëshironi. E tërë kjo faqe flet për njësitet e BIA-s dhe për
8 veshjen e tyre në një mënyrë të caktuar apo me uniformën në
9 rastet kur merrnin pjesë në operacione luftarake.

10 Dhe pyetja ime, pasi kemi parë këtë, është që, pasi keni
11 parë këtë, a i përmbaheni, vazhdoni t'i përmbaheni qëndrimit
12 që ushtarët e BIA-s nuk kanë marrë pjesë në operacione
13 luftarake?

14 Pë. Po në bazë të asaj çfarë kanë pasë detyrën, domethënë
15 edhe mandatin, përveç datës 27 e tutje, domethënë, unë nuk kam
16 ditë për këto rastet të BIA-s, domethënë, që ka marrë pjesë në
17 operacione luftarake me uniformë. Tash këtu pasi që
18 përgjithësisht flet për BIA-n, tash ky konteksti i fundit,
19 vërtetë ky paragrafi i fundit që lexova, ka mundësi të shkojmë
20 në fund të asaj?

21 Tash veç po më intereson -- a këtu po flet për civil. A
22 ka lidhje kjo tash me BIA-n këta civilët që janë 10, 20, 30
23 apo janë civilë që kanë ardhë, qytetarë që kanë ardhë? Këtu e
24 kam pak, domethënë, çështjen e raportit mes domethënë --

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

1 lutem, z. Dëshmitar, ndaloni.

2 DËSHMITARI: Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk i
4 bëni ju pyetjet këtu. A është e qartë kjo për ju? Besoj se
5 është. Ju lutem, mos i bëni këto pyetje. Dhe ju e dini shumë
6 mirë.

7 Z. Prokuror, fjala për ju.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

9 Py. Z. Ibishi, e gjitha faqja, sikurse ju thashë, pyetjet dhe
10 përgjigjet në këtë faqe që janë drejtuar z. Mustafa janë për
11 BIA-n, për uniformat apo mungesën e uniformave dhe
12 pjesëmarrjen e tyre në luftime, operacione luftarake. Në
13 gjithë faqen, pra, në gjithë faqen, diku thotë z. Mustafa
14 pjesëtarët e BIA-s rrinin me rroba civile, ishin civilë, por
15 kur angazhoheshin në operacione luftarake vishnin uniformat.
16 Dhe thotë, anëtarët e njësitit merrnin pjesë në luftime
17 qofshin këta 10, 20 a 30 persona dhe atëherë vishnin uniforma.

18 A është i qartë konteksti për ju tani, Z. Ibishi?

19 Pë. Po kjo pjesa e fundit për mu është e pakjartë. Por si do
20 që të jetë, unë mendoj që BIA nuk ka pasë mandatin të,
21 domethënë, të jetë pjesë e uniformuar në zbatimin e detyrave
22 të veta, në kuadër, po flas, në kuadër të pjesës urbane. Kjo
23 pjesa po flet për pjesën rurale. Tash këtu, megjithëse, kjo
24 është strukturë e paarmatosun sikur që ceka dhe ma herët. Dhe
25 për këtë arsye kam të pakjartë në përkufizimin e krejt kësaj.

1 Mendoj që unë e lidhi datën nga 27, kur u bë mobilizimi i
2 tërësishëm, është mundësia që edhe BIA të jetë uniformuar dhe
3 armatosun për shkak që është urdhri i përgjithshëm për
4 mobilizim, por para kësaj date e kam të pakjartë këtë çështje.
5 Domethënë, nuk kam koment në kuptim të asaj.

6 Py. Kjo është përgjigja juaj, apo jo?

7 Pë. Po.

8 Py. Z. Ibishi, ndryshojmë pakëz temën, në qoftë se është e
9 mundur. Sot dy herë na thatë --

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Edhe me lejen e të nderuarve
11 Gjykatës, do gjej dhe citimin po pak më vonë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
13 vazhdoni.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

15 Py. Z. Ibishi, të paktën dy herë sot thatë që kishte një
16 qendër ndalimi, vend ndalimi, në Llapashticë për Zonën
17 Operative të Llapit; apo jo?

18 Pë. Po.

19 Py. Z. Ibishi, mesa dini ju, a kishte ndonjë qendër tjetër
20 ndalimi apo ambient tjetër ndalimi në Zonën Operative të
21 Llapit?

22 Pë. Në bazë të dijenisë teme, jo.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen e Trupit Gjykses
24 dëshiroj t'i tregoj dëshmitarit deklaratën e vet. Deklaratën
25 që i ka dhënë ZPS-së në 14 nëntor 2019, 083639-TR-ET, Pjesa 9,

1 faqja 14.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
3 lutem, vazhdoni.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Sekretar i Gjykatës, a mund
5 ta nxjerrim këtë pjesë nëse arrini ta gjeni.

6 Py. Z. Ibishi, në pjesën që unë do t'ju tregoj - dhe kjo
7 është deklarata juaj që ju i keni dhënë Prokurorisë - ju këtu
8 flisni për të paktën dy vende të tjera, jo vetëm atë të
9 Lllapashticës. Ju lutem duroni pak sa të dalë në temë.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua t'i tregoj dëshmitarit
11 rreshtat 13 deri në 15.

12 Py. Në këto rreshta flitet për disa të ndaluar të cilët u
13 zhvendosën nga Lllapashtica dhe Prokurori ju pyet:

14 "Po pse u hoqën prej andej? Pse u zhvendosën të ndaluarit
15 nga Lllapashtica drejt për t'u çuar në Majac dhe Potok? Cila
16 ishte arsyeja që u lëvizën domethënë?

17 Dhe ju u përgjigjët:

18 "Sepse do të ishin vrarë".

19 Ai i thatë Prokurorit, a i folët Prokurorit për
20 ekzistencën e këtyre dy vendeve të tjera në Majac dhe Potok?

21 Pë. Është në -- ndëgjoni. Në aspektin kronologjik flitet për
22 një vend, domethënë, për mbajtje të personave. Edhe ai mund të
23 lëvizë prej -- sikur që është zhvillue zona prej Majacit në
24 Lllapashticë. Flitet për një vendmbajtje, mirëpo me lokacion të
25 ndryshëm. Nuk flitet për dy vendmbajtje në të njëjtën kohë. U

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 120

1 bë transferime prej një vendi në vendin tjetër. Njëna ka qenë
2 për shkak të zhvillimit të operacioneve që ne kemi zgjerue
3 territorin, por edhe në rastin kur kemi bë tërheqje në kuptim
4 të, domethënë, presionit apo sulmeve serbe për mos me ra
5 viktimë personat e mbajtur. Edhe këto janë çështje në aspektin
6 kronologjik kohor qoftë në zgjerim apo edhe në tërheqje.

7 Flitet për një vendmbajtje. Mirëpo në aspektin kohor në
8 vende të ndryshme.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Prisni pak.

11 Z. Dëshmitar, ju lutem mos luani me fjalët. Po ju
12 paralajmëroj. Përgjigjuni pyetjes, mos luani me fjalët.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

14 Py. Z. Ibishi, ta sqarojmë këtë pjesë, këtë aspekt. Disa të
15 burgosur mbaheshin në Llapashticë ku ishte dhe qendra e
16 ndalimit. Dhe për shkak të operacioneve ushtarake serbe u
17 zhvendosën në Majac dhe Potok; a është kështu?

18 Pë. Jo. Së pari kenë disa momente këtu, kur kemi -- jemi
19 zhvillue, kemi ardhë prej Majacit edhe janë transferue në
20 Llapashticë. Mandej kur fillon ofensiva e madhe serbe, atëherë
21 bëhet tërheqja, domethënë, e lokacionit apo qendrës së
22 mbajtjes nga Llapashtica tash në Potok. Se për aty është fjala
23 tani.

24 Py. E kuptoj. Pra, ajo që po thoni ju, z. Ibishi, është që
25 personat, pra, mbaheshin edhe në këto dy vendet e ndryshme e

1 tjera, të paktën përkohësisht, pra, Majaci dhe Potoku. Pra,
2 mbaheshin përkohësisht?

3 Pë. Jo në të njëjtën kohë. Jo të njëjtën kohë. Domethënë, ka
4 qenë ose Majaci ose Llapashtica, ose Llapashtica ose Potoku.
5 Domethënë, s'kanë qenë dy qendra të mbajtjes, vetëm një për
6 kohën e caktuar.

7 Py. E kuptoj. Pra, në një moment pati të burgosur që
8 mbaheshin në Llapashticë kështu?

9 Pë. Po.

10 Py. Dhe pastaj në një moment tjetër u mbajtën në Majac;
11 kështu?

12 Pë. Kur është bërë lëvizja e pozicioneve, atëherë prej Majacit
13 qa ajo qendër vetëm është dislokue në Llapashticë. Dhe s'ka,
14 nuk dy qendra.

15 Py. E kuptova. E kuptova. E kuptova këtë. Pra, personat për
16 një periudhë kohore u mbajtën në Llapashticë, u ndaluan në
17 Llapashticë dhe pastaj për një periudhë kohore në Majac dhe
18 pastaj u mbajtën në Potok?

19 Pë. Po.

20 Py. Kështu?

21 Pë. Po. Ka pasë vetëm një qendër të ndalimit, flas.

22 Py. Po ju thatë që ishte Llapashtica kjo qendër dhe sapo na e
23 konfirmuat, që në periudha të caktuara kohore personat u
24 mbajtën të ndaluar edhe në dy vendndodhje të tjera. Në harkun
25 kohor, pra, po ne po kemi në Zonën Operative të Llapit ama

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 122

1 kemi tre ambiente ndalimi. Fillimisht Llapashticën, pastaj

2 Majacin, pastaj Potokun. A është kështu?

3 Pë. Jo. Kemi vetëm një por në kohë të ndryshme ka lëviz.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dëgjova "jo" nga Mbrojtja. "Jo"

5 në shqip domethënë "no", jo. Domethënë "jo". Pastaj dëgjova

6 "jo" dhe nga ana e tij. Apo po përpiqeni t'ia sugjeroni

7 përgjigjen dëshmitarit? Apo po përpiqeni t'ia diktoni

8 përgjigjen dëshmitarit?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë

10 nuk e dëgjova këtë. Kështu që unë nuk mund ta konfirmoja apo

11 ta mohoj. Po do ju lutesha personave të mos diktojnë

12 përgjigjet, të mos sugjerojnë përgjigjet. Ju lutem qëndroni të

13 heshtur. S'e di nga doli.

14 Z. Pelaj, po ju shoh dhe ju. Po ju flas dhe ju. Po ju

15 flas të gjithëve. Po ju flas të gjithëve. Unë s'e dëgjova. Nuk

16 mund të komentoj lidhur me këtë. Po ju lutem kini parasysh

17 këtë që sapo thashë.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

19 Py. Z. Ibishi, atëherë i kthehemi përgjigjes suaj. Edhe një

20 herë pyetja ime ishte: A është e saktë, që në një moment kohor

21 personat mbaheshin në Llapashticë, në qendrën e ndalimin atje.

22 Pë. Po.

23 Py. Pastaj në Majac dhe pastaj në Potok?

24 Pë. Po. Po ka lëviz vetëm ka qenë një qendër, një vendndalim,

25 jo -- vetëm në aspektin kohor ka -- të vendit ka ndryshue dhe

1 të kohës. A përndryshe një qendër ndalimi.

2 Py. Dhe vendndodhja? Ndryshoi dhe vendndodhja apo jo z.

3 Ibishi?

4 Pë. Po. Vetëm një, domethënë, vetëm një qendër ndalimi s'ka -
5 - në aspektin kohor ka ndryshue prej një vendi në vendit
6 tjetër.

7 Py. Z. Ibishi, a kishte dhe një qendër, një vendndalimi në
8 Zonën Operative të Llapit në vendin e quajtur Bajgorë, ku
9 mbaheshin po ashtu persona të ndaluar?

10 Pë. Po ajo ka qenë kur kemi qenë Bajgorë, në fillim është
11 ajo. Fillimi, domethënë, dikun korriku i vitit 1998.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Prokuror, me sa duket ka një koment nga pala Mbrojtëse.

14 Z. PELAJ: [Përkthim] Thjesht për sqarim se unë po mendoja
15 me zë të lartë mbase, por unë po lexoja transkriptin, faqja
16 108, rreshti 7: "Pavarësisht kohës që përflitet ne kishim
17 vende të ndryshme".

18 Dhe unë me mendjen time thashë "jo", sepse thuhet
19 "Një mijë e tre vendndodhje". Kjo s'kishte lidhje me Z. Ibishi
20 a me z. Prokuror. Lexoni transkriptin. Unë nuk dëgjova askënd
21 të përmendi këtu "Një mijë e tre vendndodhje".

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Atëherë do ju sugjeroja këto t'i mbani për veten tuaj sepse
24 mund të ndikojnë tek personat e tjerë.

25 Z.PELAJ: [Përkthim] Unë s'po dëgjoja mirë. Po mendoja me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 124

1 zë të lartë. Nuk kishte lidhje me z. Ibishi. Unë s'po dëgjoja
2 fare çfarë po thoshte. Unë po ndjek transkriptin dhe këtu
3 flitet, thuhet këtu, flitet për "Njëmijë e tre vendndodhje".
4 Ju kërktoj ndjesë. Nuk e bëra me dashje.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit, për sqarimin.

7 Vazhdoni, z. Prokuror.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

9 Py. Z. Ibishi.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do të doja të përmendja, sa i
11 takon Bajgorës, në deklaratën e mëparshme të z. Ibishi që ka
12 dhënë në çështjen Latif Gashi dhe të tjerë. Me lejen tuaj,
13 dëshiroj t'i tregoj dëshminë dëshmitarit sa i takon
14 vendndodhjes së katërt ku mbaheshin persona të ndaluar nga
15 UÇK-ja në Zonën Operative të Llapit.

16 Z. Sekretar i Gjykatës, do ju lutesha të nxirrni, të
17 shfaqni në ekran dokumentin që është dokumenti i gjykimit
18 kryesor AP Numri 139 të vitit 2004, Latif Gashi dhe të tjerë,
19 Gjykata Themelore e Prishtinës, ERN SPOE0087691 [sipas
20 përkthimit] deri në 00087706, dëshmia e datës 15 korrik 2009.
21 Do ju lutesha të kaloni tek faqja 11. Faqja 11.

22 Py. Z. Ibishi, më lejoni t'ju tregoj dëshminë që keni dhënë
23 ju gjatë këtij gjykimi. Kryegjykatësi ju pyeti:

24 "Po për Bajgorën dhe Milovan Stankoviç?"

25 Dhe përgjigja juaj ishte:

1 "Ky ishte një burrë që u kap në aksion e sipër. U
2 informova që erdhi në pozicionet tona dhe kishte treguar armën
3 e tij ushtarëve dhe mendoj se duhet ta konsideroj veten me fat
4 që nuk i ndodhi gjë me e keqe, sepse ushtarët nuk e kuptuan
5 gjuhën e tij, por, në fund asgjë nuk ndodhi dhe ai u çua në
6 Bajgorë".

7 Pastaj vijon në faqen tjetër, faqja 12.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Shkojmë tek faqja 12.

9 Py. Kryegjykatësi pyet:

10 "A kishte ndonjë njeri tjetër që u mbajt i ndaluar në
11 këtë kohë në Bajgorë, në këtë periudhë kohore, pra, në
12 Bajgorë?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund të shkojmë pak më poshtë
14 në faqe. Zbresim poshtë tek faqja. Fillon tek pjesa ku thuhet
15 "a kishte ndonjë person tjetër...". Shkojmë pak më poshtë.
16 Ishte afër fundit të faqes. Po e kemi këtu. Saktë.

17 Py. Z. Ibishi, edhe kryegjykatësi ju vazhdoni me pyetje-
18 përgjigjet:

19 "A kishte ndokënd tjetër -- Ai ishte ndokënd tjetër i
20 ndaluar në atë kohë në Bajgorë?

21 Dhe përgjigja juaj ishte:

22 "Po, kishim edhe Fadil Suleviqin që po ashtu u kap në
23 flagrancë edhe të tjerë. I mbajtëm të ndaluar sepse dyshonim
24 se po përpiqeshin të krijonin struktura paralele, kishin armë.
25 Pozicioni i tyre ishte diku në Sharbanë dhe Grashticë. Kur i

1 sollën atje i takova".

2 Ju pyetën:

3 "Sa ishin ata?

4 Përgjigja juaj:

5 "Islam Mshtica u lëndua, u plagos sepse kur u kap u
6 përpoq të rezistonte, bëri rezistencë. Dhe ky person u dërgua
7 në spital dhe pastaj u çua atje. Kështu që i mbaj mend këta
8 persona".

9 Pra, mesa duket, kishte disa persona që mbaheshin të
10 ndaluar në Bajgora. A e konfirmoni këtë që i keni thënë
11 Gjykatësit?

12 Pë. Po, sigurisht se kjo qëndron.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar
14 Gjykatës, dua t'i tregoj, uroj që të jetë dhe pjesa e fundit e
15 dëshmisë së z. Ibishi, lidhur me të njëjtën temë, pra, me
16 Bajgorën.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Vazhdoni.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
20 Gjykatëse.

21 Z. Sekretar i Gjykatës, do ju lutesha të shfaqni në ekran
22 të dhënat e seancës që ka qenë dëshmitar Nuredin Ibishi, ka
23 qenë po ashtu çështja Latif Gashi dhe të tjerë, në Gjykatën
24 Themelore të Prishtinës, numër 65/2002, data 27 gusht 2002 dhe
25 është faqja e deklaratës SPOE00123560 deri në 000123574, faqja

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 127

1 3, ju lutem, që është SPOE00123562.

2 Më falni, do konsultohem shkurtimisht me kolegët nëse më
3 lejoni.

4 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
6 faleminderit për durimin. Thjesht doja të sigurohesha lidhur
7 me diçka që dua të përmend.

8 Megjithatë, në këtë faqen këtu. Është një pyetje këtu nga
9 Gjykatësi Hetues që ju drejtohet ju, z. Ibishi.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
11 Prokuror, më falni, Sekretar i Gjykatës a mund ta zmadhojmë
12 pak?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pyetja fillon: "A kishit
14 dijeni...". Fillon tek pjesa "A kishit dijeni...". Pikërisht
15 kjo pjesa këtu.

16 Py. Pyetja që ju drejtuan ju z. Ibishi, ishte si në vijim:

17 "A kishit dijeni për ndonjë civil që mbahej i ndaluar në
18 Bajgorë aso kohe?

19 Ju u përgjigjët:

20 "Jo, civil po kam dëgjuar për një grup ushtarësh të
21 paautorizuar (mund të jetë UÇK-ja) që vepronin në pjesën
22 lindore të Prishtinës, Grashticë, që u arrestuan dhe u çuan
23 atje. Ndër të ndaluarit ishte Fadil Suleviq (që tani quhet
24 Fadil Syla) dhe Islam Mshica".

25 A ja keni thënë këtë Gjykatësit Hetues?

1 Pë. Po.

2 Py. Pra, për ta përmbledhur këtë vijë, linjë të pyetjeve të
3 mia. Pavarësisht periudhave kohore, në të gjitha deklaratat,
4 flisni për ekzistencën e disa vendndodhjeve ku mbaheshin të
5 ndaluar persona, ishte Llapashtica, ishte Majaci, ishte Potoku
6 dhe së fundmi, Bajgorë; a është kështu?

7 Pë. Jo, kjo nuk është e fundit. Kjo është -- Bajgora është
8 fillimi. Unë nuk e di a po jam i kjartë. Dhe njëherë. Kjo
9 është korriku, i gushtit 1998, Bajgora.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

11 Dëshmitar. Pyetja është, pra, pyetja e Prokurorit është: Në të
12 gjitha deklaratat flisni për ekzistencën e disa vendndodhjeve
13 ku mbaheshin të ndaluar persona, Llapashticë, Majac, Potok dhe
14 Bajgorë.

15 Pavarësisht se në cilën periudhë kohore apo rendin
16 kronologjik, a është e vërtetë që personat mbaheshin të
17 ndaluar atje? A është kjo dëshmia juaj?

18 Pë. Dëshmia ime është se ne kemi pasë, zona operative e
19 Llapit e ka pasë një vend për mbajtje të personave. Vetëm në
20 kohëna të ndryshme --

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

22 jo, jo. Dua një përgjigje për pyetjen time dhe dua ta di prej
23 jush. Nëse në këto katër vende janë mbajtur të ndaluar
24 persona? Nuk dua të dëgjojë më për zhvendosjen e qendrës së
25 ndalimit. Nuk është kjo me vlerë tani. Nuk ka lidhje tani. Dua

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 129

1 t'i përgjigjeni pyetjes nëse personat mbaheshin të ndaluar
2 atje. Dhe mendoj se Prokurori thjesht po përmbledhte ato çka
3 keni thënë ju. Dhe duhet t'i përgjigjeni. Dhe nuk dua të
4 shmangni pyetjen.

5 A u mbajten njerëz të ndaluar në këto katër vende? Është
6 kollaj të thuash "po" ose "jo"

7 DËSHMITARI: Po, janë mbajtë. Mirëpo dua të shpjegoj se në
8 kohëna të ndryshme. Ju kisha lut mos t'i, domethënë, kemi pasë
9 vetëm një vendmbajtje.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
11 Dëshmitar, për mua "po-ja" mjaftonte. Ishte në periudha të
12 ndryshme kohore --

13 DËSHMITARI: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- e
15 keni përsëritur disa herë këtë, e kemi marrë parasysh këtë. Ne
16 po ju dëgjojmë me vëmendje.

17 DËSHMITARI: Në rregull.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos
19 më keqkupto. Nëse po e ngre pak tonin, po e bëj se dua t'i
20 përgjigjeni pyetjes, sepse për disa tema dua qartësi, dua ta
21 kuptoj, por kjo nuk do të thotë se nuk e kam dëgjuar se çfarë
22 keni thënë më përpara. E kam marrë parasysh. I kam vërejtur
23 ato. Ju lutem.

24 DËSHMITARI: Mirë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Thjesht jam këtu për t'u përpjekur të kuptoj çka ka ndodhur
2 aso kohe. Asgjë më shumë.

3 Z. Prokuror, fjala është për ju.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pra, nuk jam i qartë, në fakt,
5 nëse e mora përgjigjen për pyetjen e fundit. Më lejoni të shoh
6 shkurtimisht transkriptin.

7 Py. Edhe njëherë, pavarësisht periudhave kohore, pavarësisht
8 harkut kohor se kur ishin këto qendra ndalimi në periudha të
9 ndryshme kohore, ju a e konfirmoni që gjatë kohës së luftës në
10 Zonën Operative të Llapit kishte katër vendndodhje ku u
11 mbajtën të ndaluar persona? Dhe unë i përmenda ma herët cilat
12 ishin këto vendndodhje.

13 Pë. Po. Këto vendndodhje, mirëpo me kohëna të ndryshme. Po
14 saktë.

15 Py. Po. Po. E qartë. E kemi të qartë këtë. Faleminderit, z.
16 Ibishi.

17 Pë. Vërtetë, vetëm njëherë. Kemi Bajgorën, Majacin edhe
18 Lllapashticën, për tri vende a fjala se s'ka tjetër.

19 Py. Kemi diskutuar dhe Potokun sot. U përmend dhe Potoku apo
20 jo, z. Ibishi?

21 Pë. Nuk jam i sigurtë tash a u përmend dikun sot ashtu. Se më
22 ka kalu në harresë në kuptim të asaj, por për këta tri vende
23 domethënë Bajgora, Majaci edhe Lllapashtica.

24 Py. Përpara ju përmenda, ju lexova dëshminë tuaj ku keni
25 thënë aty që për një periudhë kohore ka qenë dhe një qendër

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 131

1 ndalimi në Potok dhe ju thatë "po". Po flasim për katër?

2 Pë. Nuk jam i sigurtë për -- po them, unë për këto tri.

3 Ndoshta e kam thënë, s'jam i sigurtë tash në aspektin kohor a
4 kupton se në Llapashticë ka qenë, domethënë, kjo e fundit.

5 Py. E qartë. Z. Ibishi, më herët sot në seancat e mëparshme,
6 ju bëri një pyetje pala Mbrojtëse nëse ndonjë moment gjatë
7 luftës ishit në Zllash.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Edhe flitet për këtë në faqen
9 35, rreshti 17 deri në 24 të transkriptit të sotçëm.

10 Py. Dhe ju u përgjigjët se me shumë gjasa, ka shumë mundësi
11 të keni qenë në Zllash në pjesën e dytë të muajit maj të vitit
12 1999 "kalova andej pari".

13 Pë. Po.

14 Py. E konfirmoni këtë?

15 Pë. Po.

16 Py. Në qoftë se pikërisht në këtë kohë keni qenë në Zllash,
17 nuk mund të thoni besoj që aty ka ekzistuar një vend
18 parandalimi, paraburgimi apo jo?

19 Pë. Nuk di për këtë vend që ka ekzistuar vend për ndalim.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më lejoni
21 që të konsultoj shkurtimisht kolegen time.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Vazhdoni.

24 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam nevojë

1 edhe për pesë deri në dhjetë minuta gjithsej dhe kaq më
2 nevojiten, pra, për kundërpyetjet e mia.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 lutem, që të vazhdoni me pyetje të hapura. Kjo e fundit nuk
5 ishte e përshtatshme pasi keni përfshirë edhe përgjigjen aty
6 dhe zakonisht ne nuk e lejojmë një gjë të tillë.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, që m'i
8 përkujtuat. Faleminderit, do t'i përmbahem më tutje.
9 Py. Z. Ibishi, do ta ndryshojmë tërësisht temën. Dhe pyetja
10 që kam në këtë grup pyetjesh është si më poshtë: A i keni
11 ndjekur procedurat e kësaj çështjeje?

12 Pë. Çfarë procedurash? Cillat procedura?

13 Py. A keni dëgjuar gjykimin kundër Salih Mustafës në
14 televizion, në radio, në internet?

15 Pë. Kohë pas kohe, jo rregullisht.

16 Py. A mund të na tregoni se cilët dëshmitarë keni dëgjuar,
17 dëshminë e kujt dëshmitari keni ndjekur?

18 Pë. Po pjesërisht Ibrahimin --

19 Py. Ibrahim kush?

20 Pë. Ibrahim mbiemrin -- mandej Fatmir Humollin pjesërisht.
21 Këta dy. S'më kujtohen tjerët. Kam qenë pak i ngarkuar kohës
22 fundit.

23 Py. A e keni ndjekur dëshminë e Kapllan Pardužit?

24 Pë. Pak, një pjesë, një sekuencë. Para se të vij këtu veç e
25 kam përcjellë ashtu.

1 Py. Si do t'i përshkruanit marrëdhëniet që keni me Kapllan
2 Parduzin?

3 Pë. Po marrëdhëniet si bashkëluftëtarë, si mik. Edhe normal
4 që kemi kalue çaste të përbashkëta. Dhe ka një moment që më
5 lidh me të, është se derisa unë duke i ripozicionu forcat tona
6 e kam harrue pancirin, them, këmishën mbrojtëse edhe në kohën
7 kur u bë ofensiva, ai ma dha të vetën. Dhe kështu që është një
8 moment i sakrificës tij që me atë potezë më ka mbrojtë, se po
9 të mos e kisha atë me siguri s'do të isha gjallë. Edhe ai nga
10 ajo pësoi. Për këtë arsye e llogariti edhe përkushtimin tim
11 jam mundue, kur ju keqësu gjendja, që të shkoj dhe t'ia kthej
12 me të mira. Dhe fatmirësisht që ja dualëm që ta dërgoj në
13 spital në Maqedoni dhe ai të mbijetojë gjithë asaj, pasi që
14 veç ishte çasti që ai mund të vdiste për shkak që filloi t'i
15 dekompozohet veç varra dhe t'i kundërmon. Për shkak të
16 mungesës së, domethënë, kushteve spitalore, trajtimit pasi që
17 serbët e kishin okupuar spitalin dhe asesi nuk kush mundësi.
18 Edhe ata vetë i shpallshin terrorista ata që vijnë në trajtim
19 dhe civilët, e lë ma të vijnë ushtarët. Dhe e vetmja mundësi
20 ishte që ta bartëm në Maqedoni dhe nga ai mbijetoi.

21 Py. Z. Ibishi, a e trajtoni si mik, a mendoni që Kapllan
22 Parduzi është shok i juaji, mik i juaji?

23 Pë. Po kur kam nda momentet më të vështira të jetës në luftë,
24 çka duhet të kem rezerva për të. E konsideroj mik.

25 Py. Kur e keni takuar për herë të fundit Kapllan Parduzin?

1 Pë. Unë e kam taku në Prishtinë e kam taku. S'di sa. Ishim
2 një manifestim, në një pllakë përkujtimore, zbulum një objekt
3 ku ishte domethënëse për neve, për luftës. Edhe aty patëm,
4 bëmë, nejtë, një ceremoni ashtu dhe disa imazhe.

5 Py. Kur ka ndodhur kjo?

6 Pë. Më duket -- s'po di tash me ju referu kohës. Ndoshta para
7 dy javësh, tri javësh kështu. Ndoshta më pak. S'po di, s'jam i
8 sigurtë.

9 Py. A keni diskutuar çështjen e Salih Mustafës me z. Kapllan
10 Parduzi?

11 Pë. Po. Kemi diskutu. Veç, domethënë, si po shkon procesi,
12 ashtu shkurtimisht, pasi që nuk kishim kohë të mjaftueshme për
13 të diskutu ma gjatë.

14 Py. A e dini që z. Kapllan Parduzi i ka dhënë dëshmi edhe
15 palës Mbrojtëse në një moment?

16 Pë. Po. Kam dëgju.

17 Py. A keni diskutu se çfarë ka thënë z. Kapllan Parduzi në
18 atë deklaratë?

19 Pë. Po, jo s'muj me ta ndëgjoj krejt se nuk kam, domethënë,
20 s'e kam të rëndësishme. Pjesërisht e dëgjova.

21 Py. Nuk jemi kuptuar si duhet. Pyetja që kisha unë është: A e
22 dini që z. Kapllan Parduzi i ka dhënë një deklaratë, jo gjatë
23 këtij gjyqi, por i ka dhënë palës Mbrojtëse një deklaratë në
24 një moment të caktuar kohor. A dini gjë për këtë?

25 Pë. Po, po kam dëgju se po.

1 Py. Dhe pyetja ime ishte nëse këtë deklaratë, që z. Kapllan
2 Parduzi e ka dhënë palës Mbrojtëse, ju e keni diskutuar së
3 bashku.

4 Pë. Jo, s'kam pasë kohë ta diskutojmë. E di që e ka dhënë, po
5 s'kemi pasë kohë shumë të flasim për atë.

6 Py. A keni diskutuar faktin që ti vetë i ke dhënë një
7 deklaratë palës Mbrojtëse?

8 Pë. Po. Ai e din që dhe unë e kam dhënë, po por nuk kemi
9 diskutu për detaje.

10 Py. Ju kuptoj.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'ju
12 tregoj dëshmitarit fotografinë e fundit për ditën e sotme nëse
13 më lejoni.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Vazhdoni.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Sekretar, do t'ju kërkoja që
17 të vendosim në ekrane një dokument me numër material
18 SPOE00222692 që është një fotografi e ushtarëve të UÇK-së.

19 Py. Z. Ibishi, kush është në këtë fotografi?

20 Pë. Për herë të parë po e shoh. Është -- jam unë, zëvendësi,
21 Korabi dhe këtë, kjo është një këngëtare e njohur e Kosovës,
22 Adelina Ismajli.

23 Py. Pra, personi që është i ulur kush është ai?

24 Pë. Unë jam.

25 Py. Të fillojmë nga e djathta e fotografisë. Personi më i

- 1 gjatë dhe me flokë të rëna që është në këmbë në të djathtë,
2 kush është ai?
- 3 Pë. Është zëvendësi im i brigadës Arif Muçolli, Profa.
- 4 Py. Faleminderit. Personi në këmbë ngjitur me të, personi me
5 mustaqe, kush është ai?
- 6 Pë. Është Kapllan Parduzi, Korabi.
- 7 Py. Gruaja në mes është Adelina Ismajli; kështu është?
- 8 Pë. Po.
- 9 Py. Dhe kush është personi që është në këmbë ngjitur me të,
10 në të majtë?
- 11 Pë. Është Florimi dhe ky mbiemrin Humolli e ka. Po ja harroj
12 emrin.
- 13 Py. Pra, personi i fundit në të majtë?
- 14 Pë. Humolli.
- 15 Py. Është personi Humolli është ai me kapele?
- 16 Pë. Jo, pa kapele. Ky në fund fare. A thatë në fund Humolli.
- 17 Py. Po personi me kapele?
- 18 Pë. Thashë Florimi.
- 19 Py. Faleminderit.
- 20 Py. A e dini se kur është bërë kjo fotografi?
- 21 Pë. Po. Ma merr mendja se kjo është -- se kam qenë komandant
22 brigade.
- 23 Py. A mund të na tregoni muajin, vitin?
- 24 Pë. Që kjo ka mujtë të ndodhë dikun, nëse nuk gaboj, nëntor,
25 tetor, nëntor ndoshta. Nëntor viti 1998. Edhe një gjë është

1 duhet të kërkoj shpjegim për këtë fotografi.

2 Se Adelina Ismajlit janë vjedhë nga banesa e saj prej
3 paramilitarëve serb këto fotografi dhe janë botue gjithandej
4 në tabloidet e Serbisë. Nuk e di ka e keni marrë ju këtë
5 fotografi. Se kjo, domethënë, kjo është njëna prej asaj çka
6 asaj ju kanë vjedhë në shtëpi. E mandej kanë fillue të
7 publikohen ato gjatë luftës viti 1998. Pra, me siguri burimin
8 e kanë prej, domethënë, autoriteteve serbe kjo foto që ju e
9 shfaqni tash.

10 Py. Z. Ibishi, ku është bërë kjo fotografi? Në ç'vend?

11 Pë. Sipas të gjitha gjasave është bë, sipas meje, këtu në
12 Bradash.

13 Py. Çfarë ka patur në Bradash?

14 Pë. Ka qenë shtabi i zonës, jo i zonës, po i brigadës 151,
15 Zahir Pajaziti, ku unë kam qenë komandant.

16 Py. Shkurtimisht, dua të përmend Kapllan Parduzin dhe njëherë
17 dhe pyetja ime ishte: Çfarë roli ka patur ai në Ushtrinë
18 Çlirimtare të Kosovës?

19 Pë. Ai ka qenë bashkëluftëtar i imi.

20 Py. A ka patur ndonjë rol të veçantë në UÇK për sa i përket
21 personit tuaj?

22 Pë. Ky kur u kyça unë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në
23 muajin qershor, ai ka qenë -- është kthye me armatim nga
24 Shqipëria. Edhe nga atëherë, kemi qenë së bashku, them, si
25 bashkëluftëtarë. Bashkë ashtu deri në plagosje.

1 Py. E kuptoj. Pyetja që kisha unë është: A ka patur ndonjë
2 detyrë të veçantë, të caktuar për sa i përket personit tuaj
3 brenda UÇK-së pra?

4 Pë. Nuk ka pasë detyrë të veçantë në kuptimin e asaj përveçëm
5 ka jemi shoqëru bashkë. Kur ka pasë nevojë diçka më ka marrë,
6 më ka sjellë. Kemi qenë bashkarisht, të pandashëm. S'ka pasë
7 ndonjë detyrë të veçantë në atë kuptim.

8 Py. A ka luajtur ai rolin e bodigardit, të rojës personale
9 për personin tuaj, pra, në UÇK?

10 Pë. S'muj me njoftë absolutisht atë status. Ai ka qenë
11 luftëtar i lirisë sikur të gjithë ne. Dhe mendoj se dhe s'kam
12 pasë nevojë unë për truproje, as atëherë as tash.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam dhe
14 disa pyetje, por dua të përmend një nga emrat që ju i keni i
15 keni përmendur më parë. Pyetja ime ka të bëjë me personat që
16 dëshmitari ka ndjekur gjatë këtij gjyqi, pra, për sqarim.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Prokuror, do të kisha dashur që të merrnim një pushim,
19 pavarësisht se s'ju kam njoftuar më parë. Por do të preferoja
20 që ta përfundonit seancën e kundrapyetjeve. Dhe pasi që ju
21 thatë që po përfundonit, unë mendoj që duhet të marrim një
22 pushim. Nuk dua që t'ju ushtroj trysni por do të ishte mirë që
23 ta merrnim pushimin në 4.30?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më pak kohë se aq më duhet. 10
25 minuta.

- 1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
- 2 Atëherë kur të përfundoni, do të marrim një pushim, përpara se
- 3 të mbajmë një seancë tjetër, nëse është e domosdoshme.
- 4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.
- 5 Py. Z. Ibishi, edhe një pyetje. Në fillim të tematikës së
- 6 fundit të pyetjeve të mia lidhur me përcjelljen e këtij gjyqi,
- 7 ju thatë që keni përcjellur dëshminë e një personi që quhet
- 8 Ibrahim. Kështu thatë?
- 9 Pë. S'po kuptoj Brahimi?
- 10 Py. Të transkriptit. Ju përmendët, pra, para disa minutave
- 11 dëshminë e Humollit dhe të Ibrahimit --
- 12 Pë. Po, po e përmenda. Po dëshmi po.
- 13 Py. Në rreshtin 21 --
- 14 Pë. Po.
- 15 Py. -- e përmendët. Është ky Ibrahim Mehmetaj?
- 16 Pë. Po. Me siguri, tash lëvizim në bazë të emrit, Bimi ashtu.
- 17 Po. Atë e kam pa si përmenda për dëshmitar jam pyet dhe e
- 18 përmenda që këta dy pjesërisht i kam përcjellë, vetëm disa
- 19 sekuenca jo krejt.
- 20 Py. Doja thjesht një sqarim për këtë dhe faleminderit që ma
- 21 dhatë.
- 22 Z. Ibishi, cili -- çfarë marrëdhëniesh keni me z. Salih
- 23 Mustafa të akuzuarin e kësaj çështjeje?
- 24 Pë. Si bashkëluftëtar. Asgjë s'kam personale qysh me thënë
- 25 kështu. Si bashkëluftëtar e njoh dhe kam respekt për të. Edhe

1 normal që veprimtar i çështjes kombëtare.

2 Py. A e mendoni, a e trajtoni atë si një mikun tuaj?

3 Pë. Po, pse do të deklarohej për atë. Ajo është personale e
4 imja.

5 Py. Është personale, por ne në këtë sallë gjyqi duhet të
6 kuptojmë marrëdhëniet tuaja me të akuzuarit për të vlerësuar
7 dëshminë tuaj. Kjo çështje nuk është personale. Kjo çështje
8 është e lidhur me thelbin e kësaj çështjeje. Ka të bëjë me
9 besueshmërinë tuaj si dëshmitar dhe prandaj po ju a bëj
10 pyetjen edhe njëherë. A jeni shok me Salih Mustafën?

11 Pë. Pra, unë e kam atë bashkëluftëtar edhe, domethënë,
12 çështje ma të madhe se ajo nuk ka se bashkëluftëtari. Ke qenë
13 në luftë me të. Edhe për çështje tjera nuk dua të përgjigjem.
14 Po mendoj për aspektin personal.

15 Py. Pra përgjigja që po i jepni pyetjes sime është "jo",
16 kështu është?

17 Pë. Po, për arsye se është çështje e imja personale raportet.
18 Unë të thashë respektin e kam për si bashkëluftëtarë e këtë.
19 Çështje tjera janë personale, mendoj që më perkasin vetëm mua.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
21 besoj se kjo është çështje personale. Ju duhet të përgjigjeni
22 nëse jeni shok me të apo jo. Duhet të përgjigjeni. Në këtë
23 sallë gjyqi ju nuk keni të drejtën e zgjedhjes nëse duhet të
24 përgjigjeni apo jo. Ju duhet të përgjigjeni. Jeni dëshmitar në
25 këtë sallë gjyqi dhe dëshmitari ka për detyrë të përgjigjet

1 DËSHMITARI: Kryesuese, tash më pyet a e kam mik. Unë nuk
2 kam shoqërim me të që të them ta kam mik apo diçka. Nuk kam
3 shoqëni që të dal rregullisht që të pi kafe. S'po di si ta
4 përkufizoj. Unë them se e kam bashkëluftëtar dhe kjo është.
5 Nëse mund t'ju përgjigjem.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

7 Py. Pra, nuk është shok, mik?

8 Pë. Po s'di a po më kupton. S'muj dhe mos me e quajte. Tash
9 mik e quam atë që pinë kafe, del për çdo ditë me të në
10 kuptimin e shoqërimit të vazhdueshëm. Unë e thashë, asgjë
11 s'kam ma të madhe bashkëluftëtar kur e ki dikënd. Unë tash me
12 spjegu ty, për shembull, me dikën që të pi kafe për çdo ditë,
13 të shoqërohem me atë, domethënë, raportet tona s'po di si me
14 t'i përkufizue ndryshe. Unë me Salih Mustafën kam respektin e
15 veçantë, e kam bashkëluftëtar, mirëpo nuk kemi shoqërim që të
16 them që mund ta përkufizoj si mik apo jo mik apo ndonjë
17 përkufizim tjetër. S'po di si të them. Se po t'i thuash mik
18 atëherë kupton që e ki ose e ki ose familjar ose miku i thue e
19 ki shoqërimin e rregullt me të, del me të për çdo ditë.

20 Unë s'po di si ta përkufizoj, domethënë, miqësinë,
21 afërsinë me të. Domethënë, në kuptim të asaj nuk kam shoqërim
22 të vazhdueshëm. Kur shihem me të përshëndetmi me respekt e
23 krejt ato, mirëpo nuk kam miqësi të vazhdueshme them me të që
24 mund të dalë të pi kafe, dreka apo shoqërim miqësor a
25 familjar. Se s'po di tash çka është kjo e rëndësishme ta

1 deklaroj a e kam mik. Armik s'e kam. As shoqërim kështu të
2 vazhdueshëm nuk kam. S'po di se pse është kjo e rëndësishme ta
3 them, a e kupton.

4 Py. E nderuar Gjykatëse, mjafton si përgjigje pasi e ka
5 shpjeguar në hollësisë çfarë marrëdhëniesh kanë. Dhe e kuptoj.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe
7 unë e kuptoj. Pasi na keni dhënë një përgjigje, keni shpjeguar
8 se çfarë nënkuptoni me fjalën "mik" dhe e keni përshkruar po
9 kështu edhe çfarë marrëdhëniesh keni me të. Dhe kjo është gjë
10 e rëndësishme për ne për ta ditur.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

12 Py. Z. Ibishi, a e keni takuar z. Salih Mustafa përpara
13 arrestimit të tij dhe, nëse po, sa shpesh ka ndodhur një gjë e
14 tillë?

15 Pë. Jo, s'e kam takuar.

16 Py. Nuk po flas për një rast të veçantë. Në raste të ndryshme
17 në raste kur keni bërë ndonjë veprimtari sociale, a jeni
18 takuar ndonjëherë me z. Salih Mustafa përpara arrestimit të
19 tij? Çfarëdo rasti që të ketë qenë?

20 Pë. Jo, nuk jemi takue. Kemi mujt me u taku se Prishtina
21 është e vogël, qyteti është i vogël, takohemi kalimthi
22 përshëndetmi edhe kalojmë. Domethënë, s'kam pasë ndonjë takim
23 të veçantë me të. Në kuptim...

24 Py. A e dini për çfarë akuzash bëhet fjalë në Aktakuzën
25 kundër z. Salih Mustafa?

1 Pë. Po. Po procesi është në vazhdim. S'ka mujtë ende ta njoh
2 substancën, s'e kam lexue lëndën. Nuk kam ide përveç asaj çka
3 fillimisht çka është thënë në media.

4 Py. A e dini se me cilat akuza është ngarkuar?

5 Pë. Jo. Jo me të gjitha.

6 Py. Apo për çfarë bëhet fjalë në këtë çështje?

7 Pë. Po mirë ato janë dhënë, them, është një, them,
8 pretendimet që mund të ketë qenë i përfshim në atë, mirëpo kjo
9 është faza, domethënë, prezumimi i pafajësisë është deri në
10 momentin kur ajo bëhet. Tash unë nuk di për cilat raste krejt
11 akuzohet. Nuk kam njohuri të specifikume për atë.

12 Py. Para arrestimit të Salih Mustafës, a e keni diskutuar
13 ndonjëherë atë çështje apo deklaratën e tij me atë vetë?

14 Pë. Jo.

15 Py. Si keni reaguar ndaj lajmit të arrestimit të z. Salih
16 Mustafa?

17 Pë. Po me keqardhje.

18 Py. Keni ndonjë gjë më të veçantë për të shtuar përveç
19 keqardhjes?

20 Pë. Po, më të veçantë, po mendoj, ne pjesëtarët e Ushtrisë
21 Çlirimtare të Kosovës, më duhet ta them, janë përfshi ky është
22 procesi i pestë, katër në Kosovë, ky i pesti është, ne jse, tri
23 në Kosovë dhe dy jashtë, i pesti. Na pej rolit të, domethënë,
24 viktimës po kthehemi sikur në agresor në raport me atë edhe
25 kjo po shkon në pafundësi. Unë nuk du të paragjykoj pafajësinë

1 as të Salih Mustafës, as të bashkëluftëtarëve të mi. Mendoj që
2 vetë procesi do të tregon atë realitetin në bazë të asaj çka
3 do të procesohet krejt vetë.

4 Py. Ju thatë që kjo është e padrejtë. A e mendoni apo e
5 konsideroni këtë Gjykatë të padrejtë?

6 Pë. Tash duhet ta them. Unë kam qenë deputet në Kuvendin e
7 Kosovës në legjislaturën kur është miratue. Nuk e kam bërë me
8 vullnet këtë votë. Nga kuptime se së pari kur nis në Asamblenë
9 Parlamentare të Këshillit të Evropës të miratohet kjo
10 rezolutë, e dinim fort mirë se kanë qenë akuzat për trafikim
11 të organesh. Ndërsa në hetimet preliminare të z. Williamson u
12 konstatu se edhe e dini fort mirë "shpia e verdhë" e gjithë
13 ato akuza që janë bërë. Dhe në fund, domethënë, mbaron raporti i
14 z. Williamson se nuk ka trafikim të organeve por ka diçka
15 tjetër. Mirëpo rezoluta është miratue në Asamblenë
16 Parlamentare të Këshillit të Evropës falë asaj që s'ka pasë
17 edhe lobim prej qeverisë së atëhershme.

18 Tash me bërë një krahasim, kur Bosnja-Hercegovina e ka
19 ngritë çështjen e Srebrenicës në Asamblenë Parlamentare për
20 gjenocid, 8000 e diçka kur janë vra brenda disa ditësh, ju e
21 dini fort mirë që me lobin pro-rus e pro-serb e pro-bjellorus
22 është refuzue kërkesa e Bosnjë-Hercegovinës për miratimin e
23 rezolute për gjenocid në Bosnjë-Hercegovinë.

24 Do të thotë lehtësisht është miratue kjo rezolutë për
25 krimet e pretenduara për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të

1 Kosovës. Edhe unë kam qenë edhe një kam -- atëherë kur isha
2 deputet kam pasë një shtojcë, të them, me bë një ndryshim që
3 të hetohen të krimet që janë kry në Kosovë, jo vetëm krimet e
4 pretenduara ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të
5 Kosovës. Dhe kjo më ka mbetë që realiteti.

6 Py. Z. Ibishi, a keni votuar për krijimin e kësaj Gjykate apo
7 kundër krijimit të saj kur ishit anëtar i Parlamentit të
8 Kosovës?

9 Pë. Pa vullnet kam votue për se isha para dy - jo vetëm unë
10 po edhe të tjerët - ishin para dy dilemave. A ta miratojmë e
11 të na gjykojnë vendet demokratike, siç është Bashkimi
12 Evropian, normal me Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo të
13 shkon në Kombet e Bashkuara edhe të vijnë regjimet e Rusisë e
14 të Kinës e të Bjellorusisë edhe për këtë arsye ishte vota pro.

15 Py. A keni patur kontakte me z. Salih Mustafa pas arrestimit
16 të tij?

17 Pë. Jo.

18 Py. A keni qenë -- a keni patur kontakte me anëtarë të
19 familjes së z. Salih Mustafës pas arrestimit të tij?

20 Pë. Jo.

21 Py. Në një moment, ju i keni dhënë një deklaratë palës
22 Mbrojtëse, kush ju ka venë në kontakt me palën Mbrojtëse me
23 qëllim që të jepni këtë deklaratë.

24 Pë. Unë sa di avokati më ka kërkuë. Edhe munda ka me shpreh
25 gatishmërinë për ato çka di ta deklaroj, qato rrethanat çka

1 janë të miat që dua t'i mendoj që t'i them me qëllim të
2 ndriçimit apo të zbardhjes apo mbarëvajtjes së procesit me
3 qëllim të korrektësisë.

4 Py. A është ndonjë anëtar i familjes së Salih Mustafës, a ka
5 bërë ndërlidhjen mes jush të palës Mbrojtëse?

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe kjo është pyetja ime e
7 fundit, e nderuar Gjykatëse.

8 Py. A dëshironi ta përsëris pyetjen?

9 Pë. A ka bërë ndërlidhjen -- edhe njëherë, a ka mundësi?

10 Py. A ka ndonjë -- ju kërkoj ndjesë Z. Ibishi. Po e përsëris
11 edhe njëherë. A ka bërë ndonjë ndërlidhje mes jush dhe
12 Mbrojtjes, a ka ndërhyrë, pra, ndokush nga familja e Salih
13 Mustafës mes jush dhe Mbrojtjes me qëllim që ju të jepni
14 deklaratë për Mbrojtjen?

15 Pë. Jo.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këtu
17 përfundojnë pyetjet e mia. Po përpara se ta përfundojë këtë
18 zyrtarisht, më lejoni që të bëjë një konsultim fare të
19 shkurtër me kolegen time.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Vazhdoni.

22 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Këtu përfundojnë pyetjet e mia,
24 e nderuar Gjykatëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit, z. Prokuror.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, z. Humolli [shih
3 kontekstin].

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
5 do të mbajmë një pushim prej 15 minutash dhe pastaj nëse ka
6 nevojë do të mbajmë një seancë prej 45 minutash, por së pari
7 Asistentes së Gjykatës do t'i kërkoja që të shoqëronte z.
8 Ibishi nga salla e gjyqit.

9 Z. Ibishi, do të mbajmë një pushim prej 15 minutash.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Pra, pas pushimit do të vazhdojmë, megjithatë dua të
14 marrim vesh se ku ndodhemi aktualisht për të planifikuar më
15 tutje.

16 Mbrojtësja e Viktimave, a do keni pyetje?

17 ZNJ. VOSENBERG:[Përkthim] Faleminderit, e nderuar
18 Gjykatëse. Unë kam në fakt disa pyetje. Janë dy tematika në të
19 cilat dua të gjej disa sqarime dhe sipas mendimit tim, kjo nuk
20 do të zgjasë më shumë se nja dy minuta. Kaq mendoj se do të
21 zgjasë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Pala Mbrojtëse, ju a do të dëshironi të bëni pyetje
25 shtesë?

1 Z. SHALA: [Përkthim] Për momentin, jo. Më pas, të shohim.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
3 për sa i përket planifikimit të seancës së mëtejshme kaq
4 mjafton. Marrim atëherë një pushim 15 minutës deri në orën
5 16.45.

6 Seanca mbyllet.

7 --- Pauza fillon në orën 16.34

8 --- Seanca rifillon në orën 16.50

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
10 procesverbal, jemi të njëjtë persona që ishim dhe më përpara.

11 Znj. Asistente e Gjykatës ju lutem mund të sillni
12 dëshmitarin.

13 [Dëshmitar vijon dëshminë]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
15 se erdhët përsëri z. Ibishi. Ditë e gjatë, por jemi afër
16 fundit.

17 Mbaruam me pyetjet nga pala Mbrojtëse, nga Zyra e
18 Prokurorit të Specializuar. Tani do t'i jap fjalën Mbrojtëses
19 së Viktimave, t'i japim edhe atyre mundësinë të bëjnë disa
20 pyetje qartësuese.

21 Mbrojtësja e Viktimave, fjala është për ju.

22 ZNJ. VOSENBERG:[Përkthim] Faleminderit.

23 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

24 Py. Z. Ibishi, sikurse ju tha dhe Gjykatësja kam nevojë për
25 disa sqarime që lidhen me gjërat që keni thënë sot në dëshminë

1 e sotme, pra, në Gjykatë.

2 Pyetja e parë që kam unë është si në vijim, sot pala
3 Mbrojtëse ju pyeti për rregullat, rregullat që duhet të
4 zbatonin ushtarët.

5 ZNJ. VOSENBERG:[Përkthim] Kjo është faqja 21 e
6 transkriptit, rreshti 12.

7 Py. Kur ju pyeti Mbrojtja, ju konfirmuat, në dëshminë tuaj
8 sot, se ekzistonin rregulla të atilla. Dhe ju thatë dhe po
9 citoj ato që thatë ju nga transkripti:

10 "Si Shtab i Përgjithshëm i kishim disa rregulla. Ato që
11 s'i kishim u përpoqëm t'i zhvillonim vetë. Ne si eprorë,
12 bazuar në ekspertizën tonë u përpoqëm të krijonim disa
13 rregulla në mënyrë që të garantonim rendin dhe disiplinën në
14 brigada dhe njësitë vartëse".

15 A e mbani mend këtë?

16 Pë. Po.

17 Py. Faleminderit. Nëse e kam kuptuar siç duhet edhe ju ishit
18 i përfshirë në përgatitjen e këtyre që përmendët?

19 Pë. Po, isha.

20 Py. Dhe kur thoni, sikurse thatë edhe sot në dëshminë tuaj,
21 "Ne si eprorë" ishim të angazhuar të përfshirë në përgatitjen
22 e rregullave, kujt i referoheni ju me "eprorë"? Dhe përpiquni
23 të jeni sa më specifik që të jetë e mundur nëse mund të na
24 thoni ndonjë emër, nëse s'mundeni mund të na thoni pozitën,
25 rolin që kanë pasur në strukturën hierarkike.

1 Pë. Po. Mund t'i referohem edhe emrave. Por dua të specifikoj
2 se këto rregulla janë për strukturën e Ushtrisë Çlirimtare të
3 Kosovës jo dhe për civilë se ato janë domethënë jashtë asaj.
4 Çështja tjetër është se këto rregulla i kam bë unë, pasi jam
5 jurist, po i kanë bë edhe bashkëpunëtorët tjerë që them tash
6 pa marrë parasysh nivelin por mjaftojnë që kanë juristë apo
7 kanë pasë një karrierë ushtarake apo policore edhe/apo njohuri
8 tjera edhe i kemi bë domethënë.

9 Mirëpo një masë të madhe na kanë ardhë pi Shtabit të
10 Përgjithshëm, domethënë, si rregulla, domethënë, që janë, unë
11 po them kohën, domethënë, preliminare para se të na vijnë ato,
12 në do raste i kemi bë dhe ne. Po kur kanë ardhë ato atëherë
13 janë miratue në nivel të, domethënë, të gjithë Kosovës, pra,
14 Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe
15 kanë qenë unike.

16 Py. Po, në rregull. Më falni t'ju ndërpres. Se pyetja ime
17 lidhej specifikisht me atë që thatë në dëshminë tuaj "ne si
18 eprorë" me këtë fjali e kam. Kujt i referoheni ju specifikisht
19 me "ne, si eprorë"? Kjo është pyetja ime.

20 Pë. U referohem prej komandantit të zonës,
21 zëvendëskomandantit, mua si shef shtabi, komandantët e
22 brigadave, mandej sektorëve edhe domethënë edhe të tjerëve që
23 janë përfshi në këtë proces.

24 Py. Faleminderit. Pra, diskutuam që u përgatitën këto
25 rregulla, tani pyetja ime e fundit lidhur me këtë temë është:

1 Kush ishte përgjegjës për zbatimin e tyre në praktikë, në
2 terren? Më konkretisht, kush, përgjegjësia e kujt ishte të
3 garantonte rendin dhe disiplinën? Kush e kishte përgjegjësinë?
4 Pë. Po këto rregullore, këto përfshiheshin, domethënë,
5 detyrimin apo për policinë ushtarake si të veprojë për
6 mbajtjen e rendit dhe disiplinës ushtarake ndaj pjesëtarëve të
7 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra, flas për zonën. Pasi që
8 mandej ka pasë edhe, domethënë, aspekte edhe të, domethënë,
9 marrjes masa disiplinore edhe në kuadër të strukturës së,
10 domethënë, komanduese që kanë marrë në raste të caktuara ndaj
11 vartësve, nëse kanë bërë shkeljen e detyrave të punës dhe të
12 disiplinës. Edhe normal që kanë pasë edhe procesin e ankimimit
13 te komisioni në rast se ka pasë pakënaqësi në lidhje me
14 vendimin e shkallës së parë. Ajo ka qenë. Përafërsisht kjo një
15 përshkrim i shkurtër megjithëse thash po flasim për rendin,
16 rregullat dhe disiplinën në kuadër të ushtrisë. Mirëpo, ma
17 vonë, shumë shpjet na edhen ajo, domethënë, rregullorja e
18 Shtabit të Përgjithshëm që ishte, domethënë, universale për
19 krejt pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në të gjitha
20 zonat.

21 Py. Në rregull. Pra, ju thatë diçka që unë do ta lexoj:

22 "...kishte aspekte të masave disiplinore në strukturat
23 komanduese".

24 Pra, pyetja ime ishte: Kush ishte përgjegjës për zbatimin
25 e tyre, a është e drejtë të them që ishin komandantët

1 përgjegjës për zbatimin e rregullave?

2 Pë. Jo. Ishte policia ushtarake ajo që e mbajke rendin në
3 kuptimin e asaj. Ndërsa për zbatimin e këtyre masave ka qenë
4 gjithashtu policia ushtarake që në kuptimin e ndërmarrjes së
5 masave.

6 Py. Ju po thoni që komandantët nuk kishin kurrfarë
7 përgjegjësie në ruajtjen e rendit dhe disiplinës?

8 Pë. Jo. Kanë pasë edhe ata autorizime të caktuara, sidomos
9 për masat minore sa i përket tërheqjes së vërejtjes, dhënien e
10 dhënë disa vërejtjeve, të them kështu, deri në një nivel.

11 Mandej ato tjerat kanë qenë çështje që i ka marrë edhe
12 komisioni disiplinor në kuadër të, domethënë, të zonës.

13 Py. Besoj se me këtë përgjigje e mbyll këtë temë. Kam edhe
14 shkurtimisht diçka lidhur me mënyrat e komunikimit.

15 Sot na thatë në faqen 32, të transkriptit të sotshëm,
16 flisni për shtabin në Zonën Operative të Llapit dhe na thatë
17 që kishit komunikim me radio, radiolidhje. Mbani mend që e
18 thatë këtë??

19 Pë. Po.

20 Py. A mund të na tregoni çfarë forma komunikimi kishte në
21 dispozicion për ju në atë kohë, aso kohe për njësitet e
22 ndryshme. Cilat ishin mjetet e komunikimit që kishit ju në
23 disponibël aso kohe?

24 Pë. I kishim, domethënë, kishim sistemin e radiolidhjeve me
25 numra thirrës dhe normal ndodh me sistemin me shifër për shkak

1 të, domethënë, që mos me u zbulue, domethënë, qëllimet tona.
2 Ka qenë e folja me shifër, me qëllim që mos t'i zbulon armiku
3 bisedat tona. Edhe kanë qenë në nivel të, domethënë, pej
4 komandës apo komandantit të zonës, zëvendësit, shefit të
5 shtabi. Brigadat kanë pasë numër thirrës dhe të ndryshëm.
6 Kështu qe aspekti i komunikimit. Problemi ka qenë që ne i kemi
7 pasë sistemin simpleks, domethënë, pa ndërmjetësim të
8 repetitorit, po vetëm ajo çka ka qenë direkt në afërsi. S'ka
9 mujtë me çu signalin në largësi të mëdha në kuptimin e asaj,
10 po vetëm në afërsi. Për arsye se vetë s'kemi pasë
11 infrastrukturën e repetitorëve për me mujt me trasmetu
12 signalin e, domethënë, sistemeve të radios në distancë më të
13 madhe.
14 Py. Me sa kuptoj unë, këto repetitorë, nuk e njoh mirë këtë
15 terminologji, a kanë lidhje me komunikim radio këto
16 repetitorët?
17 Pë. Po. Për arsye se sistemi "Simpleks" është veç direkt prej
18 pranuesit, të dhënësin edhe të kundërtën. Ndërsa ky sistemi
19 "Semidupleks" shkon nëpër mes sistemit të repetitorëve,
20 transmetues signali në largësi me qëllim që të mbulon një
21 sipërfaqe ma të madhe të pranuesve dhe të dhënësve në sistemin
22 e radiokomunikimit.
23 Py. Qartë. Veç komunikimit me radio, a kishit ndonjë formë
24 tjetër komunikimi, pajisje të tjera?
25 Pë. Kemi pasë edhe telefonat satelitorë.

1 Py. Cilat njësi i kishin në dispozicion a i kishin -- cilat
2 njësi i kishin në dispozicion këto pajisje?

3 Pë. Zakonisht ishin shefat e, domethënë, komandantët e
4 brigadave, ishte komandanti i zonës, shefi i shtabit,
5 zëvendëskomandanti i zonës dhe këta ishin personat pasi që
6 edhe njësia e kufizuar për shkak të vetë asaj që ishte -- ata
7 janë telefona të shtrenjtë edhe të kushtueshëm për këtë arsye
8 edhe numri ka qenë i kufizuar domethënë. Mirëpo mundësia e
9 komunikimit ka qenë në çdo moment, problem ka qenë vetëm
10 kostoja e lartë.

11 Py. Ishin telefona satelitor. Po telefona të rregullt
12 normalë?

13 Pë. Po ato nuk i përdorshim rregullisht. Atje përdorshim
14 radiolidhjet për shkak se telefonat satelitor kishin koston e
15 lartë, domethënë, të pagesës, të minutazheve, për këtë arsye
16 vetëm e kursenim për raste të domosdoshme të komunikimit.

17 Py. Në rregull. E mora përgjigjen e pyetjes sime.

18 Faleminderit, Z. Ibishi.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, Mbrojtësja e Viktimave.

21 ZNJ. VOSENBERG:[Përkthim] Faleminderit, të nderuar
22 Gjykatës.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala
24 Mbrojtëse, a keni pyetje shtesë për këtë dëshmitar?

25 Z. SHALA: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse. Nuk kemi

1 pyetje shtesë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, pala Mbrojtëse.

4 Z. Prokuror, pyetjet e Mbrojtëses së Viktimave, a nxitën
5 nevojën për të parashtruar pyetje të tjera?

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kemi pyetje shtesë, të
7 nderuar Gjykatës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
9 mirë.

10 Tani, z. Dëshmitar, ju drejtuan pyetje pala Mbrojtëse,
11 Prokuroria e Specializuar dhe Mbrojtësja e Viktimave. Tani
12 është radha e Trupit Gjykues.

13 Unë nuk kam asnjë pyetje për ju në këtë moment, po do të
14 pyes kolegët e mi nëse ata kanë ndonjë pyetje shtesë. Po shoh
15 në të djathtë. Jo. As në të majtë.

16 Nuk ka pyetje nga ana e Trupit Gjykues në këtë moment. Ky
17 është fundi i dëshmisë suaj, z. Ibishi. Dua t'ju falënderoj
18 për përpjekjet tuaja, për dëshminë tuaj, që jam e bindur se do
19 ta ndihmojë Trupin Gjykues të kuptojë më së miri se çka ka
20 ndodhur aso kohe edhe të gjejmë të vërtetën, të zbulojmë të
21 vërtetën.

22 Faleminderit. Ju uroj rrugë të mbarë dhe i kërkoj znj.
23 Asistente të Gjykatës t'ju shoqërojë jashtë sallës së gjyqit.
24 Më lejoni t'ju kujtoj edhe njëherë që nuk do ta diskutoni
25 dëshminë tuaj me askënd jashtë sallës së gjyqit. Faleminderit

1 edhe njëherë.

2 DËSHMITARI: Faleminderit. Respekt. Punë të mbarë.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit, znj. Asistente e Gjykatës.

6 Palët dhe pjesëmarrësit a kanë gjë për të parashtruar me
7 Trupin Gjygues?

8 Prokurori i Specializuar?

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Asgjë?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Mbrojtësja e Viktimave?

12 ZNJ. VOSENBERG:[Përkthim] Asgjë prej nesh.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala

14 Mbrojtëse?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Asgjë prej nesh.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

17 mirë. Atëherë takohemi nesër në orën 9.30 me dëshminë e

18 Dëshmitarit 1100.

19 Seanca mbyllet këtu.

20 --- Seanca përfundon në orën 17.05

21

22

23

24

25